



FA-të kontribuojnë denjësisht për rritjen e sigurisë, përkrah Komandës Multidimensionale



» faqe 3



MINISTRI VENGU DHE SHSHPFA, GJENERALLEJTËNANT KINGJI, PRITËN KOMANDANTIN E MISIONIT TË KFOR-IT, GJENERALMAJOR ENRICO BARDUANI

Ministri i Mbrojtjes z. Pirro Vengu dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant Arben Kingji, pritën në një takim të veçantë, komandantin...



faqe 3



SHQIPËRIA ZGJIDHET NË KËSHILLIN E ORGANIZATËS NDËRKOMBËTARE PËR NDIHMAT DETARE NË LUNDRIM (IALA)

U zhvillua në Singapor, Asambleja e parë e Përgjithshme e Organizatës Ndërkombëtare për Ndihamat Detare në Lundrim (International Organization for Marine Aids...



faqe 4



TRE VITET E TMERRIT TË AGRESIONIT RUS NDAJ POPULLIT UKRAINAS

Tre vjet pas fillimit të pushtimit rus në Ukrainë, më 24 shkurt 2022, mbështetja ndërkombëtare për Ukrainën mbetet e fuqishme dhe e larmishme. Mbështetja nga Shtetet e Bashkuara: Shtetet e Bashkuara kanë qenë një nga mbështetësit...



faqe 8

FA-të kontribuojnë denjësisht për rritjen e sigurisë, përkrah Komandës Multidimensionale

Toga e Forcave të Armatosura e dislokuar pak ditë më parë në Bosnje-Hercegovinë, në kuadër të misionit EUFOR, është integruar plotësisht dhe në kohë rekord me Batalionin Multidimensional. Me praninë e tyre, 30 trupat shqiptarë kontribuojnë në rritjen e sigurisë jo vetëm në Bosnje-Hercegovinë, por në të gjithë rajonin.

Kontingjenti shqiptar do të shërbejë për rreth 6 muaj në këtë mision, në të cilin kanë si fushë përgjegjësie kontrollin e turmave, trajtimin e mjeteve të pashpërthyera dhe evakuimin e të plagosurve.



Në ambientet e Regjimentit të Operacioneve Speciale (ROS) në Zall-Herr u zhvillua ceremonia e përcjelljes së trupave të Batalionit Komando, të cilët do të shërbejnë me mision ushtarak “KFOR”, Pejë, Kosovë, si pjesë e angazhimit të NATO-s.

Në ceremoni morën pjesë shefi i Shtabit të Forcave Tokësore, Kolonel Ilirjan Dauti, Komandanti i ROS-it, Kolonel Ajet Jata, si dhe familjarë dhe miq të efektivëve të kontingjentit VII.

Gjatë fjalës së tij, kolonel Dauti theksoi rëndësinë e këtij angazhimi, duke vlerësuar kontributin dhe traditën e trupave komando në operacionet ushtarake në kuadër të NATO-s. Në këtë mision do të shërbejnë 30 efektivë, të cilët do të vazhdojnë të përfaqësojnë me dinjitet Forcat e Armatosura të Shqipërisë.



Niset kontingjenti i Batalionit Komando në KFOR, Pejë, Kosovë





Ministri i Mbrojtjes z. Pirro Vengu dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant Arben Kingji, pritën në një takim të veçantë, komandantin e misionit të KFOR-it, gjeneralmajor Enrico Barduani. Zhvillimet më të fundit në Kosovë ishin në qendër të diskutimeve mes ministrit Vengu dhe komandantit të KFOR-it.

Nga ana e tij, ministri i Mbrojtjes i shprehu komandantit të KFOR-it, mbështetjen e Shqipërisë për këtë mision, ku aktualisht kontribuojmë në mënyrë aktive. Teksa e cilësoi misionin e KFOR-it, një mburojë shumë të rëndësishme për stabilitetin dhe sovranitetin e Kosovës, ministri i Mbrojtjes nënvizoi rëndësinë e ndërveprimit dhe bashkëpunimit të KFOR-it me të gjitha strukturat e sigurisë së Kosovës, të cilat tashmë janë një realitet. Më tej gjenerallejtënant Arben Kingji me komandantin e KFOR-it, gjeneralmajor Enrico Barduani diskutoi për çështjet e sigurisë rajonale, duke vlerësuar rolin dhe kontributin e rëndësishëm të vendit tonë dhe KFOR-it në këtë drejtim. “Forcat e Armatosura mbeten të angazhuara për të dhënë kontributin e tyre në drejtim të paqes, sigurisë dhe stabilitetit në rajon dhe më gjerë”, - u shpreh gjenerallejtënant Kingji.



Ministri Vengu dhe SHSHPFA, gjenerallejtënant Kingji, pritën komandantin e misionit të KFOR-it, gjeneralmajor Enrico Barduani

AKMC vazhdon trajnimet në kuadër të projektit “Flood North Albania”

Një trajnim i rëndësishëm për ndihmën e parë në raste emergjencash, në kuadër të projektit “Flood North Albania”, i financuar nga Bashkimi Europian dhe DG ECHO, u zhvillua në qytetin e Shkodrës.

Trajnimi, i drejtuar nga z. Ilir Aliaj, drejtor ekzekutiv i CDDI (Qendra për Zhvillimin dhe Demokratizimin e Institucioneve), u mbajt në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Qendrën Kombëtare të Urgjencës Mjekësore dhe përfaqësues nga Shqipëria, Kosova, Mali i Zi, Greqia dhe Maqedonia e Veriut.

Pjesëmarrësit përfshinin: Forcat e Ndërhijres së Shpejtë (FNSh); Përfaqësues të pushtetit lokal: Shkodër, Vau Dejës & Malësi e Madhe; Strukturat e emergjencave civile në nivel lokal. Vullnetarë të angazhuar në menaxhimin e emergjencave

Trajnimi përfshiu: Simulime emergjencash të jetës reale dhe praktikë direkte për çdo pjesëmarrës. Ky trajnim është një hap i rëndësishëm për përgatitjen e strukturave të emergjencave civile dhe angazhimin e vullnetarëve ndaj fatkeqësive natyrore. Pjesëmarrësit do të jenë të përfshirë në stërvitjen finale në prill!





Shqipëria zgjidhet në Këshillin e Organizatës Ndërkombëtare për Ndihmat Detare në Lundrim (IALA)

Uzhvillua në Singapor, Asambleja e parë e Përgjithshme e Organizatës Ndërkombëtare për Ndihmat Detare në Lundrim (International Organization for Marine Aids to Navigation - IALA), pas kalimit të saj në statusin e një organizate ndërqeveritare, më 22 gusht 2024.

Ky event i rëndësishëm mbledhi rreth 400 delegatë nga 65 vende, përfshirë zyrtarë të lartë qeveritarë dhe liderë të industrisë detare, duke ofruar një platformë për shkëmbimin e ideve dhe praktikave më të mira në fushën e sigurisë lundrimore.

Shqipëria u përfaqësua nga komandanti i Forcës Detare/Rojës Bregdetare nënadmiralet Adnand Agastra, i cili në fjalën e tij theksoi nevojën për një sistem të avancuar ndihmesh detare që të lehtësojë transportin detar të qëndrueshëm dhe të mbrojë mjedisin detar, veçanërisht në ekosistemin e Mesdheut.

Gjatë asamblesë, Shqipëria u zgjodh në Këshillin e IALA-s, duke dëshmuar angazhimin e saj për të përmirësuar standardet ndërkombëtare të sigurisë lundrim dhe për të promovuar praktikat e qëndrueshme.

Ky aktivitet theksoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar në përmirësimin e sigurisë dhe efikasitetit në lundrim, duke nxitur gjithashtu ruajtjen e mjedisit detar për brezat e ardhshëm.

Shqipëria është e përkushtuar të luajë një rol aktiv në këtë proces, duke promovuar standardet më të larta në fushën e ndihmave detare dhe duke kontribuar në një të ardhme më të sigurt dhe të qëndrueshme për mjedisin detar.



In memoriam

Tonin Tuci lindi, më 17 mars të vitit 1964, në Rrëshen, Mirditë.

Shkollën e Mesme të Bashkuar e kreu në Kukës dhe më pas vazhdoi studimet e larta në Fakultetin Ekonomik.

Ndër vite z. Tonin u rrit profesionalisht, duke ndjekur kurse dhe trajnime të ndryshme, duke dhënë kontributin e tij në mjaft institucione. Prej vitit 2009 dhe në vazh-

dim ai punoi si audit i brendshëm në Ministrinë e Mbrojtjes.

Më 24 shkurt 2025, në moshën 61 – vjeçare, befas pushoi së rrahuri zemra e tij.

Ai u nda prej familjarëve, miqve dhe kolegëve duke lënë pas mungesën e birit, prindit, bashkëshortit të dashur, mikut dhe shokut të mirë.

Të qoftë dheu i lehtë!



Ekipi amerikan i **Institute for Security Governance** realizoi një takim në Komandën Mbështetëse

Një ekip amerikan i Institute for Security Governance zhvilloi në ambientet e Komandës Mbështetëse një vizitë studimore, me qëllim vlerësimin e progresit dhe planin e masave për mirëmbajtjen e mjeteve të kalueshmërisë së lartë (HMMWV).

Ekipi u prit në takim nga Komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Aleksandër Pando.

Përmes një prezantimi ata u njohën me misionin, strukturën, operacionet në mbështetje të Emergjencave Civile, operacionet për pastrimin e territorit nga municionet e rrezikshme dhe kontributin e Komandës Mbështetëse në operacione të organizuara dhe drejtuara nga NATO.

Ekipi amerikan tregoi një vëmendje të shtuar për Qendrën e Riparimit të Mjeteve të Teknikës Tokësore të Forcave të Armatosura, duke u fokusuar në kapacitetet njerëzore dhe materiale në mënyrë të veçantë për riparimin e mjeteve të kalueshmërisë së lartë, problematikat në realizimin e kësaj detyre dhe vizionin që ka kjo strukturë e rëndësishme.




Efektivë të Batalionit të Xhenios kanë përfunduar operacionin në mbështetje të emergjencave civile në bashkinë Vlorë



Batalioni i Xhenios ka ndërhyrë me sukses në zonën e Kalasë, Bashkia Vlorë, me qëllim largimin e inerteve shkëmbore që kishin bllokuar aksesin e lëvizjes për 4 familje.

Me angazhimin e 6 forcave dhe përdorimin e 5 mjeteve, ata kanë arritur të pastrojnë rrugën dhe të sigurojnë lëvizjen e banorëve duke i dhënë fund kështu kësaj problematike të krijuar si rezultat i përmytjeve të muajit tetor.

Ky operacion tregon gatishmërinë, përgatitjen dhe efektivitetin e forcave xheniere, të cilët gjenden më pranë komunitetit në rastet emergjente.



Operacione EOD për pastrimin e vendit nga municionet në bashkitë Delvinë dhe Himarë

Efektivët e Kompanisë EOD vazhdojnë të përmbushin misionin për pastrimin e territorit nga municionet e paplasura.

Specialistët EOD përfunduan operacionin xhenier në fshatin Shën Vasil dhe Nivicë, njësi administrative Lukovë, bashkia Himarë duke e vlerësuar municionin e gjetur tip predhë artilerie blindëshpuese, të prekshëm dhe të lëvizshëm.

Duke zbatuar rregullat e sigurimit teknik u bë transportimi dhe magazinimi i municionit në depon e Batalionit të Xhenios.

Një tjetër operacion u realizua në fshatin Kalas, njësi administrative Vergo, bashkia Delvinë.

Gjatë këtij operacioni dy ditë u identifikuan municione të tilla si granata pushke të periudhës së Luftës së Dytë Botërore, granata dore kundër-këmbësorisë, të cilat u vlerësuan si të paprekshme dhe të palëvizshme, duke bërë më pas dhe asgjësimin në vend të tyre.



KOLONEL HYSNI GJERGJI

Në këtë 3 vjetor të luftës në Ukrainë, po shtrohet pyetja: Ia vlen kostoja e mbështetjes së Ukrainës apo do të kushtojë më shumë mos-mbështetja që do të thotë inkurajim dhe mbështetje për Rusinë? Përkrahësit e qasjes së Trump, i cili gjithçka e mat me dollarë, kosto dhe tarifa, argumentojnë se fondet e parashikuara për ndihmë ushtarake Kievit e tejkalojnë pritshmërinë, dhe nuk ia vlen të shpenzohet më shumë. Rusia sipas tyre e ka fituar luftën dhe Ukraina duhet të shpëtojë atë çfarë ka mbetur, por edhe atë aspak falas, por duke e paguar me minerale të rralla. Në këtë luftë, mineralet e çmuara po vihen në balancë me jetët e humbura, ku pranohet që Rusia ka më shumë se 700.000 viktima prej nises së luftës, dhe më shumë se kaq ushtarë dhe civilë ukrainas. Për jetët e humbura dhe lotët e nënave ukrainase dhe ruse, askush nuk po flet deri sot, madje bijtë e k... përfitojnë të bëjnë marrëveshje për të nxjerrë përfitim nga ky konflikt i përgjakshëm.

Deklaratat e fundit të presidentit të SHBA-së dhe rezolutat e fundit të OKB-së do të dukeshin të ekzagjeruara edhe nëse artikulohehin nga vetë Putin para shkurtit 2025. Neni 5 i thënë ndryshe “sulmi ndaj një anëtarit, është sulm kundër të gjithëve” është vënë në tryezë dhe po vihet në diskutim për herë të parë pas vitit 1949, kur NATO u krijua. Për këtë realitet të ri gjeopolitik, ish-presidenti rus Medvedev shprehej: Në qoftë se para tre muajsh do më thoshin se Tramp do kishte qasje pozitive për luftën e Rusisë, unë do të qeshja me lot. Këtë fakt “La stampa” javën e kaluar e vendos si titull: “Qeshje në Rusi dhe lot në Europë”.

Grupi evropian i përkrahjes së Ukrainës, që mbështet dhënien e ndihmave ushtarake për Kievin, argumenton se kostoja do të jetë më e lartë nëse nuk mbështesim Ukrainën dhe nuk e mbajmë vijën e frontit të luftës me Rusinë, të paktën aty ku është. Këto kosto të mos mbështetjes do të jenë sigurisht më të mëdha për vendet e Baltike dhe pjesën tjetër të Europës, të cilat ndajnë kufirin tokësor me Rusinë dhe Bjellorusinë.

Nëse do të vazhdohej të ndihmohet Ukraina dhe sanksionohet Rusia, me siguri do të dobësohet makina ushtarake ruse, e cila nuk do të mund ta përballojë pa fund fushatën ushtarake. Por nëse Ukraina nuk ndihmohet atëherë Kievit do të dorëzohet dhe siç u deklarua nga Trump, mund të mos ketë më Ukrainë. Akoma nuk dihen termat e marrëveshjes për Ukrainën në Riad dhe “pa Ukrainën dhe BE-në” midis SHBA-së dhe Rusisë, por zhgënjim dhe pasiguri do të ndjehet në të gjithë Europën ish-sovjetike, së paku.

Në këtë realitet të ri gjeopolitik tre polar me SHBA-të, Rusinë dhe Kinën duhet sa më shpejt të formësohet dhe poli i katërt, ai i BE-së. Për t’u formuar ky pol duhen në radhë të parë që liderët e Europës së sotme të ngrihen në nivelin e baballarëve themelues: kryeministrit francez Robert Schuman; Jean Monnet; kancelarit gjerman Konrad Adenauer; të italianit të shquar Spinelli, autor i “Ventotone” dhe i belgut Paul-Henri Spaak. Këta evropianë idealistë hodhën themelet e BE-së që kanë rezistuar deri sot, por nuk menduan atëherë “për zgjedhjet e ardhshme por për brezat e ardhshëm”- tamam siç i përkufizonte në atë kohë liderët e vërtetë Curcilli.

Fituesi i zgjedhjeve të 23 shkurtit në Gjermani dhe kancelari i ardhshëm Friedrich Merz, nga deklaratat e tij të para tregojnë se do të ndjekë rrugën e liderit të parë të partisë së tij CDU, themeluesit të BE-së Adenauer. Friedrich Merz, deklaroi një ditë pas fitores në zgjedhje se: “Evropa duhet të forcojë sigurinë e saj duke e shkëputur varësinë që ka nga SHBA-të në fushën e mbrojtjes. Merz, nga mbështetës i zjarrtë i marrëdhënieve të ngushta me SHBA-në, befasoi me tonin e ashpër, duke u shprehur se, prioriteti im absolut do të jetë forcimi i Evropës, në mënyrë që të mund të arrijmë pavarësinë nga SHBA-të hap pas hapi, duke nënkuptuar nevojën për një mbrojtje të pavarur evropiane. Liderët evropianë, bashkë me kryeministrin kanadez Justin Trudeau u mblodhën në Kiev, më 24 shkurt 2025, për të shprehur mbështetjen e tyre ndaj Ukrainës në përvjetorin e tretë të fillimit të pushtimit rus. Në takim Presidenti gjerman Frank-Walter Steinmeier, dënoi agresionin rus në Ukrainë, duke thënë se Rusia është përgjegjëseja e vetme për nisen e luftës. Me gjithë mbështetjen nga Shtëpia e Bardhë, Rusia nuk ka fituar asnjë centimetër legjitimitet në këtë konflikt. Është Rusia ajo që e filloi këtë luftë, e cila nuk ka asnjë centimetër legjitimitet. Zhvillimet e fundit dhe distancimi i SHBA-së nga mbrojtja evropiane e kanë forcuar edhe më shumë vendosmërinë e Evropës për vetëmbrojtje.

Kostoja e ndihmës ushtarake për Ukrainën nga Gjermania, si fuqia numër një e Europës dhe numër katër e botës, pas SHBA-së, Kinës dhe Japonisë llogaritet përafërsisht 0,1 % të PBB-së gjermane. Ndërkohë që gjatë luftës së parë të Gjirit në 1991, Gjermania kontribui gjashtë herë më shumë, përkatesisht 0,6 % të PBB-së në një realitet gjeopolitik krejt tjetër, ku Gjermania ishte e pa kërcënuar drejtpërdrejt nga askush. Në atë kohë kjo shumë korrespondonte me më shumë se 4 % të buxhetit federal gjerman, duke iu përgjigjur me vendosmëri kërcënimeve të sigurisë globale, kur ekzistonte vullneti politik ndërkombëtar. Mbështetja e Ukrainës nga Gjermania aktualisht është sa një e gjashta e mbështetjes së luftës së gjirit, por në këtë rast mbështetja e saj ndikon drejtpërdrejt në rritjen e sigurisë së Europës dhe për rrjedhim të vetë Gjermanisë.

Kostot e pasojave do të jenë më të larta nëse mbështetja ndërpritet. Lufta në Ukrainë është gjeografikisht shumë më afër dhe

Kostoja e (MOS) mbështetjes së Ukrainës



ka implikime më të mëdha sigurie në Evropë. Arsyet kryesore për rritjen e kësaj kostoje do të jenë kryesisht: Përgatitje e Europës për dyndje shtesë të refugjatëve të luftës, të cilët sigurisht do të shtohen; NATO dhe Siguria të Baltikut do të vihet në pikëpyetje: si dhe ndërprerja e tregtisë me Ukrainën do të rrisë tej mase kostot e jetesës së evropianëve. Përveç kësaj, ka edhe shumë kosto indirekte për shkak të humbjes së aftësisë së parandalimit perëndimor të luftërave, gjë që i bën konfliktet e ardhshme në botë më të mundshme dhe rënie të kredibilitetit dhe besimit tek vlerat dhe fuqia e demokracisë europiane. Nëse mosmarrëveshja, paqëndrueshmëria gjeopolitike dhe ekonomike do të çonte drejt një fitoreje ruse, atëherë ekonomia, diplomacia dhe shoqëria europiane, britanike, ballkanike dhe e Turqisë do të vuante për një kohë shumë të gjatë, deri sa të gjente rrugën e daljes nga kjo disfatë.

Kostoja e mbështetjes së Ukrainës do të duhet të krahasohet dhe gjykohej përballë kostove europiane të shkaktuara nëse Rusia fiton.



Mos mbështetja perëndimore për Ukrainën do të çonte në një fitore ushtarake, diplomatike dhe gjeostrategjike të Rusisë, e cila do të diktojë kushtet e një armëpushimi, duke çuar ndoshta në pushtimin e territoreve të tjera dhe vendosjen e një qeveri kukull në Kiev. Me fitoren e supozuar ruse sfera e ndikimit të saj global dhe rajonal do të rritej dhe shpresat në pranimin në BE dhe NATO të Ukrainës do të shkatërrohehin përfundimisht. Evropa sot ka një ekonomi, afërsisht 9 herë më të madhe se Rusia, duke e bërë atë plotësisht të aftë të zbatojë një strategji parandaluese, duke rritur prodhimin e armëve, vitalizimin dhe modernizimin e industrisë ushtarake, dhe krijimin e një strukture mbrojtëse europiane. Me një diplomaci të zgjuar dhe vullnet politik Evropa e bashkuar duhet të pranojë në gjirin e saj të gjithë shtetet e Ballkanit perëndimor dhe Turqinë, për t’u bërë një aktor i katërt i fuqishëm, ndoshta më i fuqishmi gjeopolitik i përtej viteve 2025. Pas fitores, deklaratave, urdhrave ekzekutivë dhe lëvizjeve diplomatike të Trump, urgjenca është edhe më e madhe.

Rusia, nëse lejohet, përmes sukseseve të saj ushtarake do bëhet e më e inkurajuar, dhe do jetë do një kërcënim më i madh dhe i drejtpërdrejt për sigurinë europiane, në veçanti në rajonet e pambrojtura, duke filluar te korridori tokësor ndërmjet Kaliningradit dhe Bjellorusisë, si të ndikojnë shumë rëndë në sigurinë e shtetet baltike (Estoni, Letoni dhe Lituanit), të cilët pas kësaj fitoreje të blerë do të jenë të izoluar plotësisht nga Evropa. Për ta penguar këtë akt të pritshëm, do të duhej që NATO dhe BE të rrisin ndjeshëm aftësinë ushtarake konvencionale, duke shtuar investimet në tanke, sistemet e mbrojtjes ajrore, sistemet e mbrojtjes detare, kibernetike, të dronëve (UAV) dhe sistemet e raketave supersonike. Sado që të rriten shpenzimet ushtarake europiane për të mos lejuar Rusinë të

forcohet ushtarakisht, ato përsëri do të jenë më të ulëta se pasojat, nëse e kundërta do të ndodhë.

Aktualisht në Ukrainë jetojnë përafërsisht 31 milionë banorë në zonat e kontrolluara nga qeveria ukrainase. Bazuar në raportet e publikuara të popullsisë së zhvendosur deri në fund të 2024 në rajonet e pushtuara nga Rusia, ata variojnë nga 37 % në 67 %, përkatesisht nga 9.4 deri 19.1 milionë ukrainas, të cilët kërkojnë strehim jashtë Ukrainës. Kjo rritje e migracionit drejt dhe brenda Evropës që nga fundi i luftës së dytë botërore është i paprecedentë. Me skenarin e fitores së Rusisë parashikohet që përafërsisht 20 % që do të thotë (1,9 deri 3.8 milion) do të emigrojnë në Gjermani dhe shtete të tjera të Europës perëndimore. Ky fenomen do të rrisë koston e jetesës së qytetarëve europiane, në hapësirën e banimit, kujdesin shëndetësor, punësimin, sigurinë dhe arsimimin.

Rusia, fituese e luftës me perëndimin mund të çojë edhe në një rënie drastike të eksporteve europiane, të cilat sot janë në disa dhjetëra miliardë euro drejt Ukrainës. Nga ana tjetër rreth 6 miliardë euro investime direkte europiane në Ukrainë do të pamundësohen. Humbjet në investimet perëndimore sipas këtij skenari do të ishin një ngjarje e sigurt.

Pasojat negative gjeopolitike, diplomatike, ushtarake dhe ekonomike do të përhapeshin dhe shtriheshin shumë përtej Evropës. Një pushtim i suksesshëm rus i Ukrainës do t’u tregonte shteteve të tjera dhe kryesisht shteteve të vogla, se agresioni ushtarak dhe fuqia e ashpër janë strategji të suksesshme të shekullit XXI. Ky perceptim i krijuar do të minonte vlerën dhe aftësinë e pranuar të zgjidhjes paqësore të konflikteve, si dhe do të rriste shpeshtësinë e konflikteve ndërkombëtare, destabilizimin e rendit dhe sigurisë globale nga fuqitë apo aleancat e fuqishme ushtarake.

Me ekonominë e saj të luftës të orientuar drejt prodhimit të armëve dhe pajisjeve ushtarake, Rusia ka të ngjarë të bëhet frymëzuesi dhe furnizuesi i diktatorëve dhe autokratëve, në botë Europë në Korenë e Veriut, Iran, si dhe satelitëve të Rusisë siç është Serbia, e cila aktualisht është shteti më i militarizuar në Ballkan, duke lënë pas Kroacinë, Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë.

Paqja qëndron në parandalimin e besueshëm, që është një instrument strategjik për të ndikuar në sjelljen e armikut. Në thelbin e saj, teoria e parandalimit supozon se vendimet e një kundërshtari të ndikohen nga një analizë racionale kosto-përfitim dhe se ndryshimi i llogaritjeve të kundërshtarit duke rritur kostot e tij e agresionit. Një aspekt i rëndësishëm i analizës kosto-përfitim të Rusisë janë pritshmëritë e saj në lidhje me vullnetin politik dhe angazhimin e shteteve perëndimore për të ofruar ndihmë afatgjatë për Ukrainën. Prandaj është vendimtare në perëndim besueshmërisht për të qenë të përkushtuar ndaj mbështetjes gjithëpërfshirëse dhe të fuqishme. Çdo vonesë, reduktim apo kufizim i ndihmave ushtarake për Ukrainën, do i japë Moskës do të jetë shpërblim për agresorin rus.

Duke iu përmbajtur vazhdimisht parimeve të parandalimit, demokratitë perëndimore mund t’i bëjnë të qartë Rusisë se konflikti nuk mund të fitohet ushtarakisht dhe kështu të krijojnë kushtet për negociatat e paqes. Një rritje e konsiderueshme e mbështetjes ushtarake, së bashku me aspektin ekonomik dhe diplomatik, jo vetëm që do ta ndihmonte Ukrainën në terma afatshkurtër, por gjithashtu do t’i dërgonte një sinjal të fortë Rusisë se kostot e vazhimit të luftës, qoftë në formën e humbjes ushtarake, sanksioneve ekonomike apo izolim ndërkombëtar, do të jenë për të, të pa negociueshme. Fatkeqësisht edhe Luftërat moderne do të përfundojnë kur të shterojë gjaku dhe paratë.



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Të ruash njerëzillëkun dhe integritetin në një botë shpeshherë të vështirë dhe sfiduese është një ‘luftë’ e përditshme, shpesh e dështuar, sepse të jetosh mes njerëzve do të thotë të përballësh me realitete të ndryshme, padrejtësi, hipokrizi, lakmi, egoizëm, por të mbetesh njeri nënkupton të ruash virtytet si ndershmëria, dhembshuria dhe respekti.

Suksesi i madh nuk qëndron vetëm te arritjet materiale, por te ruajtja e vlerave njerëzore përkundër sfidave.

Shoqëria shpesh mund të ndikojë te karakteri i një individi. presioni social, përplasjet morale dhe ndikimi i grupit mund ta bëjnë një person të devijojë nga parimet e tij. Të mbetesh njeri do të thotë të mbash identitetin tënd moral dhe të mos lejosh që rrethanat të të ndryshojnë në mënyrë negative.

Suksesi si Masë e Integritetit

Në një botë ku suksesi shpesh matet me pasuri apo pushtet, kjo thënie e kthen vëmendjen te suksesi më i madh, të mbetesh njeri i mirë. Kjo kërkon vetëdije, përlësi dhe forcë karakteri për të mos u korruptuar nga tundimet e botës.

“Të jesh njeri” nuk është vetëm një fakt biologjik, por edhe një përpjekje e vazhdueshme për të ruajtur vlerat thelbësore të humanizmit. Çdo individ ndodhet përballë zgjedhjeve morale, dhe mbajtja e një zemre të pastër në një botë që shpesh mund të jetë e ftohtë dhe e padrejtë është një sukses i jashtëzakonshëm. Në një botë ku njerëzit shpesh ndryshojnë për të përshtatur rrethanat, suksesi i vërtetë qëndron te ruajtja e humanizmit dhe e vlerave, pavarësisht sfidave.

A mbetesh njeri në këtë botë të mbarsur antivlerash?

Të mbetesh njeri në një botë ku imoraliteti, pashpirtësia dhe servilizmi janë të pranishme është e vështirë, por jo e pamundur. Varet nga forca e karakterit, parimet dhe vullneti për të mos u dorëzuar para presioneve të jashtme. Shpesh, shoqëria ushtron presion që individët të përshtaten me rregullat e pashkruara të hipokrizisë dhe interesave personale. Ata që përpiqen të mbeten të ndershëm mund të ndihen të izoluar ose të humbin mundësi. Megjithatë, ata që e ruajnë integritetin e tyre shpesh fitojnë një qetësi shpirtërore dhe një ndjenjë vetë respekti që nuk mund të blihet me asgjë.

Njerëzit shpesh e shohin servilizmin si rrugë për të mbijetuar në një sistem të korruptuar. Disa zgjedhin rrugë më të lehta për të arritur sukses, duke lënë mënjanë parimet.

Kur e gjithë shoqëria e pranon një sjellje si normale, është e vështirë të qëndrosh ndryshe pa u ndjerë i përjashtuar.

A ia Vlen të Luftosh për të Mbetur Njeri?

Ruajtja e dinjitetit dhe ndershmërisë të bën të ndihesh mirë me veten. E vërteta dhe drejtësia kanë vlerë afatgjatë, edhe pse mund të mos japin përfitime të menjëhershme. Edhe nëse bota është e padrejtë, çdo njeri ka mundësinë të ndikojë sadopak në ambientin përreth duke mbetur shembull i mirë.

Jetë e vështirë por e paqte kur njerëzit i sheh në sy dhe nuk të vjen ‘rëndë’ nga vetja

Kjo është filozofia më e bukur e jetës. Ndonëse jeta është e vështirë, paqja e vërtetë vjen kur mund t’i shohësh njerëzit në sy pa turp dhe, mbi të gjitha, kur nuk të vjen rëndë nga vetja.

Kur jeton me ndërgjegje të pastër, pa maska dhe pa gënjeshtër, nuk ke frikë nga shikimi i askujt. Nuk ndien nevojën të fshehësh veten apo të justifikohesh.

Jeta shpesh të vë përballë sfidave ku mund të zgjidhësh rrugën e lehtë, por të gabuar, ose rrugën e drejtë, por më të vështirë. Të mbash integritetin tënd, edhe kur është e vështirë, të jep një ndjenjë paqeje dhe krenarie të brendshme.

“Të ecësh mes njerëzve, e të mbetesh njeri, është sukses i madh”



**TË MBETESH NJERI, ME NDERSHMËRI,
DHEMBSHURI DHE INTEGRITET ËSHTË
SFIDË, SIDOMOS NË NJË BOTË KU SHPESH
VLERËSOHEN FORCA, SUKSESI DHE INTERESI
PERSONAL MBI VIRTYTET HUMANE.**

Nuk ka paqe më të madhe sesa të flesh natën pa pendesa, duke ditur që nuk ke shkelur mbi parimet e tua. Kur nuk ke nevojë të fshehësh asgjë apo të ndihesh i rënduar nga zgjedhjet e tua, je vërtet i lirë.

Por ndoshta pikërisht kjo sfidë është ajo që e bën të qenit njeri kaq domethënës.

Kjo sfidë ndihet më e vështirë, kur sheh ose përjeton padrejtësi dhe duhet të vendosësh nëse do të reagosh apo do të heshtësh. Të qëndrosh i drejtë kur bota rreth teje nuk është e tillë është e vështirë.

Kur njerëzit që i ke besuar të lëndojnë, është e lehtë të bëhesh cinik ose të kthesh të njëjtën energji pas. Por të mbetesh i ndershëm dhe i hapur është sfida e vërtetë.

Kur arrin diçka të madhe, mund të joshesh të harrosh rrënjët, vlerat dhe njerëzit që të ndihmuan. Të mbetesh i thjeshtë dhe i ndershëm është një test i madh.

Kur jeta të shtyn në cep dhe duket sikur nuk ka zgjidhje të ndershme, është e lehtë të devijosh. Por të ruash integritetin edhe në kohë të vështira është ajo që të bën vërtet të fortë. Në një botë ku imazhi dhe paraqitja shpesh vlejnë më shumë se përmbajtja, të qëndrosh autentik dhe i sinqertë mund të jetë një sfidë e përditshme.

Por ndoshta, pikërisht këto momente e bëjnë të qenit njeri kaq të vlefshëm.

Si të Mbetesh Njeri në një Botë të Vështirë?

- Mos e humb integritetin për përfitime afatshkurtra.
- Qëndro pranë njerëzve që ndajnë të njëjtat vlera me ty.
- Mbro të vërtetën, edhe kur është e vështirë.
- Mos u bë pjesë e servilizmit, edhe nëse duket si rruga më e lehtë.

Nëse ndjek moralin dhe ndërgjegjen tënde, mund të mbetesh njeri, edhe kur të gjithë të tjerët zgjedhin rrugë të tjera. Edhe pse është më e vështirë, është një fitore më e madhe dhe më e qëndrueshme sesa çdo sukses i bazuar në hipokrizi dhe servilizëm. Është e thjeshtë në këtë jetë të bëhesh ‘pis’.

E dua jetën me sfida, por me fytyrë të pastër, një jetë e lehtë ka peshën e një ndërgjegjeje të rënduar (shpatullat janë të pafuqishme për peshat të rënda)...

Pasuria, suksesi dhe opinioni i të tjerëve janë kalimtare, ajo që mbetet është ndjesia jote për veten.

Të mbetesh njeri, me ndershmëri, dhembshuri dhe integritet është sfidë, sidomos në një botë ku shpesh vlerësohen forca, suksesi dhe interesi personal mbi vertytet humane.

TRE VITET E TMERRIT TË AGRESIONIT RUS NDAJ POPULLIT UKRAINAS

Tre vjet pas fillimit të pushtimit rus në Ukrainë, më 24 shkurt 2022, mbështetja ndërkombëtare për Ukrainën mbetet e fuqishme dhe e larmishme.

Mbështetja nga Shtetet e Bashkuara: Shtetet e Bashkuara kanë qenë një nga mbështetësit kryesorë të Ukrainës. Së fundmi, Kievi dhe Uashingtoni kanë arritur një marrëveshje për eksplorimin e përbashkët të burimeve minerale, që synon të forcojë marrëdhëniet dypalëshe dhe të kontribuojë në rindërtimin ekonomik të Ukrainës.

Qëndrimi i Bashkimit Evropian: Bashkimi Evropian ka rikonfirmuar mbështetjen e tij për Ukrainën. Në një samit të sigurisë të mbajtur në Kiev, presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, premtoi përsheptimin e dërgesave të armëve dhe municioneve në Ukrainë, si dhe ndihmë të re financiare prej 3.5 miliardë eurosh.

Përfshirja e Kanadasë: Kryeministri kanadez, Justin Trudeau, gjatë të njëjtit samit, njoftoi për mbështetje të re ushtarake dhe financiare për Ukrainën, duke përfshirë edhe dhurimin e fondeve të ngrira ruse për qëllime të rindërtimit.

Roli i Kosovës: Edhe pse Ukraina nuk e njeh pavarësinë e Kosovës, kjo e fundit ka ofruar mbështetje të konsiderueshme. Kuvendi i Kosovës miratoi një rezolutë në mbështetje të Ukrainës, më 3 mars 2022. Që atëherë, Kosova ka ndihmuar me armatim, trajnime ushtarake dhe ka strehuar gazetarë ukrainas. Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ka marrë pjesë në takime ndërkombëtare për të rikonfirmuar mbështetjen për Ukrainën.

Qëndrimi i Rusisë: Pas tre vitesh konflikti, Rusia është përballur me sfida të mëdha ekonomike dhe ushtarake. Megjithatë, presidenti rus, Vladimir Putin, ka shprehur gatishmëri për të rifilluar negociatat diplomatike me Ukrainën, duke përfshirë edhe menaxhimin e përbashkët të rezervave të mineraleve të rralla në territoret e pushtuara.

Mbështetja ndërkombëtare për Ukrainën mbetet e fortë dhe e shumanshme, duke përfshirë ndihmë ushtarake, financiare dhe diplomatike. Ndërkohë, Rusia po përballet me sfida të brendshme dhe presion ndërkombëtar, duke e bërë të mundshëm rifillimin e negociatave për paqe.

Si është sot gjendja social - ekonomike në Ukrainë?

Pas tre vitesh konflikti të ashpër me Rusinë, Ukraina përballet me sfida të mëdha socio - ekonomike.

Kostoja e Rindërtimit dhe Rimëkëmbjes: Sipas një raporti të përbashkët nga Qeveria e Ukrainës, Banka Botërore, Komisioni Evropian dhe Kombet e Bashkuara, vlerësohet se Ukraina ka nevojë për 524 miliardë dollarë për rindërtim dhe rimëkëmbje gjatë dekadës së ardhshme. Kjo shifër përfaqëson një rritje të konsiderueshme nga vlerësimet e mëparshme dhe reflekton dëmet e mëdha në infrastrukturë, veçanërisht në sektorët e banimit, transportit, energjisë, tregtisë dhe arsimit. Vetëm dëmet direkte janë llogaritur në 176 miliardë dollarë, me mbi 2.5 milionë familje të prekura nga shkatërrimi ose dëmtimi i banesave të tyre.

Buxheti dhe Financimi për 2025: Për vitin 2025, qeveria ukrainase, me mbështetjen e donatorëve, ka ndarë 7.37 miliardë dollarë për të adresuar nevojat prioritare në fusha si banimi, arsimi, shëndetësia, mbrojtja sociale, energjia, transporti, furnizimi me ujë, çminimi dhe mbrojtja civile. Megjithatë, ekziston ende një hendek financiar prej 9.96 miliardë dollarësh për nevojat e rindërtimit dhe rimëkëmbjes për këtë vit. Mobilizimi i sektorit privat mbetet thelbësor për suksesin e procesit të rimëkëmbjes së Ukrainës.

Parashikimet Ekonomike: Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) ka parashikuar se, nëse lufta përfundon deri në fund të vitit 2025, Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) i Ukrainës mund të rritet me 4% në vitin 2024, ndërsa inflacioni mund të arrijë në 10%, i ndikuar nga çmimet e larta të ushqimeve dhe dobësimi i monedhës kombëtare, hryvnia. Në vitin 2025, rritja ekonomike pritet të jetë midis 2.5% dhe 3.5%, si rezultat i përmirësimit të kapaciteteve energjetike dhe uljes së presioneve mbi çmimet.

Marrëveshjet Ekonomike dhe Ndihma Ndërkombëtare: Ukraina dhe Shtetet e Bashkuara kanë arritur një marrëveshje ekonomike kornizë që përfshin qasjen amerikane tek mineralet e rralla në Ukrainë, një hap që synon të forcojë ekonominë ukrainase dhe të tërheqë investime të huaja.

Pavarësisht sfidave të mëdha, Ukraina vazhdon të marrë mbështetje të konsiderueshme ndërkombëtare dhe po ndërmerr hapa për të adresuar nevojat emergjente dhe për të planifikuar rimëkëmbjen afatgjatë të vendit.

Sfidat me të cilat po përballet Ukraina

Ukraina po përballet me sfida të jashtëzakonshme në rindërtimin dhe rimëkëmbjen e saj, si pasojë e shkatërtimeve të mëdha nga lufta.

Disa nga sfidat kryesore përfshijnë:

1. Dëmet infrastrukturore masive

Lufta ka shkatërruar qytete të tëra, me më shumë se 176 miliardë dollarë dëme në rrugë, ura, ndërtesa dhe sistemet energjetike. Veçanërisht, sulmet ndaj rrjetit energjetik të Ukrainës kanë lënë miliona njerëz pa energji elektrike gjatë dimrit.

2. Hendeku financiar i rindërtimit

Sipas Bankës Botërore, rindërtimi i plotë i vendit mund të kushtojë rreth 524 miliardë dollarë gjatë dekadës së ardhshme. Pavarësisht ndihmave nga SHBA, BE dhe FMN, Ukraina ende ka një mungesë prej 9.96 miliardë dollarësh për financimin e menjëhershëm të projekteve prioritare në vitin 2025.

3. Pasiguria ekonomike dhe inflacioni

Ekonomia e Ukrainës është tkurrur ndjeshëm që nga viti 2022. Megjithëse pritet një rritje modeste prej 2.5% – 4% në 2024-2025, inflacioni i lartë (rreth 10%) dhe zhvlerësimi i monedhës janë sfida të mëdha për stabilitetin ekonomik.

4. Pasojat sociale dhe demografike

Mbi 6 milionë ukrainas janë larguar nga vendi, ndërsa miliona të tjerë janë zhvendosur brenda Ukrainës. Rënia e popullsisë aktive dhe mungesa e fuqisë punëtore po krijon probleme për rimëkëmbjen ekonomike dhe rindërtimin.

5. Çështjet e sigurisë dhe minimi i tokës

Lufta ka lënë miliona hektarë tokë të minuar, duke e bërë të pamundur kthimin në normalitet për shumë rajone bujqësore dhe urbane. Ukraina është një nga vendet më të minuara në botë sot, dhe procesi i çminimit mund të zgjasë dekada.

6. Angazhimi i investitorëve të huaj

Ukraina kërkon të tërheqë investime të huaja për të rindërtuar ekonominë, por pasiguria e vazhdueshme e luftës e vështirëson këtë proces. Marrëveshja e fundit me SHBA-të për mineralet e rralla është një hap drejt stabilizimit ekonomik.

Pavarësisht këtyre sfidave, Ukraina vazhdon të marrë mbështetje të fortë ndërkombëtare dhe po punon për të ndërtuar një të ardhme më të qëndrueshme.

Roli i Shqipërisë në mbështetje të Ukrainës

Që nga fillimi i agresionit rus ndaj Ukrainës në shkurt 2022, Shqipëria ka demonstruar mbështetje të palëkundur për sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës. Në mars 2022, Kuvendi i Shqipërisë miratoi një rezolutë që dënonte ashpër agresionin e Federatës Ruse dhe shprehte solidaritet me popullin ukrainas.

Në përvjetorin e tretë të fillimit të luftës, më 24 shkurt 2025, Kuvendi i Shqipërisë, në bashkëpunim me Ambasadën e Ukrainës,

organizoi shfaqjen e filmit “Kur erdhi pranvera në Bucha”. Ky aktivitet synonte të përkujtonte viktimat e konfliktit dhe të theksonte mbështetjen e vazhdueshme të Shqipërisë për Ukrainën.

Përveç veprimeve simbolike dhe diplomatike, Shqipëria ka mbështetur sanksionet ndërkombëtare kundër Rusisë dhe ka ofruar ndihmë humanitare për Ukrainën.

Në një vizitë pune në Kiev, Ministri i Jashtëm i Shqipërisë rikonfirmoi angazhimin e vendit për paqe, stabilitet dhe zhvillim, duke theksuar mbështetjen e palëkundur për sovranitetin e Ukrainës.

Në arenën ndërkombëtare, Shqipëria ka bashkëpunuar ngushtë me aleatët perëndimorë për të mbështetur Ukrainën, duke përfshirë edhe periudhën kur shërbente si anëtare jo e përhershme e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Përmes këtij roli, Shqipëria ka kontribuar në adresimin e krizës ukrainase dhe në promovimin e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare.

Në përgjithësi, Shqipëria vazhdon të qëndrojë krah Ukrainës, duke ofruar mbështetje politike, diplomatike dhe humanitare në përpjekjet e saj për të mbrojtur sovranitetin dhe integritetin territorial.

Dhe Ministria e Mbrojtjes së Shqipërisë ka demonstruar mbështetje të vazhdueshme për sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës.

Në mars 2022, Shqipëria mori pjesë aktive në takimet e Komisionit NATO-Ukrainë, ku aleatët u zotuan të vazhdojnë mbështetjen financiare dhe ushtarake për Ukrainën, si dhe ndihmën në fushën e mbrojtjes kibernetike.

Në janar 2025, Shqipëria dhe Ukraina nënshkruan një marrëveshje 10-vjeçare për bashkëpunim në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Kjo marrëveshje synon forcimin e kapaciteteve mbrojtëse të Ukrainës dhe integrimin e industrisë së mbrojtjes në bazën teknologjike dhe industriale evropiane. Gjithashtu, Shqipëria angazhohet të ofrojë trajnim në gjuhën angleze për pilotët dhe personelin teknik ukrainas.

Në dhjetor 2024, qeveria shqiptare miratoi dërgimin e katër ushtarakëve në Komandën e NATO-s në Wiesbaden, Gjermani, për të ndihmuar dhe trajnuar Forcat e Armatosura të Ukrainës. Ky angazhim pasqyron përkushtimin e Shqipërisë për të kontribuar në përpjekjet ndërkombëtare për mbështetjen e Ukrainës në përballimin e sfidave të sigurisë.

Përveç mbështetjes ushtarake, Shqipëria ka ofruar ndihmë humanitare dhe ka mbështetur sanksionet ndërkombëtare kundër Rusisë, duke qëndruar krah për krah me aleatët perëndimorë në mbrojtje të vlerave demokratike dhe të drejtës ndërkombëtare.



Partnerët e NATO-s

TAKOHEN ME SHTABIN USHTARAK

NDËRKOMBËTAR NË TAKIMIN

DYVJETOR ME PARTNERËT

Divizioni i Sigurisë Bashkëpunuese i Stafit Ushtarak Ndërkombëtar të NATO-s (IMS) priti takimet e para dyvjeçare të vitit 2025 me Përfaqësuesit Ushtarakë Partnerë. Pjesëmarrësit nga 22 Kombet Partnere të NATO-s dhe Shtabi Ushtarak i Bashkimit Evropian diskutuan rezultatet e Komitetit Ushtarak të Sesionit të Shefave të Mbrojtjes të janarit 2025 dhe theksin e vazhdueshëm të NATO-s mbi Partnerët në dekadat e ardhshme. Takimi u hap nga Drejtori i Përgjithshëm i Shtabit Ushtarak Ndërkombëtar, gjenerallejtënant Janusz Adamczak. Pjesëmarrësit u takuan gjithashtu me Kryetarin e ri të Komitetit Ushtarak të NATO-s, Admiralin Giuseppe Cavo Dragone.

Në hapjen e takimit, gjenerallejtënant Adamczak nënvizoi rëndësinë e partnerëve dhe sigurisë bashkëpunuese për NATO-n. “Në këtë mjedis sigurie të përfshirë nga kriza, të kesh dhe të jesh partnerë të besueshëm është me rëndësi të madhe”, - tha ai. Drejtori i Përgjithshëm i IMS-së u ndal edhe në Sesionin e Komitetit Ushtarak të Shefave të Mbrojtjes të janarit 2025, duke vënë në dukje se në total, 56 përfaqësues ushtarakë aleatë dhe partnerë morën pjesë në aktivitet.

Pas prezantimit të gjenerallejtënant Adamczak, Drejtori i Divizionit të Sigurisë Bashkëpunuese IMS, gjeneralmajor Dacian-Tiberiu Ierban, informoi mbi përpjekjet e vazhdueshme për të përmirësuar ndërveprimin e NATO-s me Partnerët. “Interoperabiliteti është një përgjegjësi e përbashkët e të gjitha palëve të interesuara, e cila përfshin shumicën e njërive të NATO-s dhe kërkon një koordinim të vazhdueshëm dhe gjithëpërfshirës të përpjekjeve”, - tha gjeneralmajor Ierban.

Gjatë ditës, përfaqësuesit partnerë ushtarakë u takuan edhe me Kryetarin e ri të Komitetit Ushtarak të NATO-s, Admiralin Giuseppe Cavo Dragone. Kryetari shprehu besimin e tij se Partneritetet e NATO-s janë thelbësore për misionin e NATO-s. “Në këtë botë komplekse, siguria nuk ndërtohet në izolim, por përmes partneriteteve të forta dhe të qëndrueshme”, - deklaroi Admirali Cavo Dragone, duke shtuar se ai shpresonte të “lidhte dhe të ndërtonte marrëdhënie personale” me Partnerët.

Me iniciativën e IMS-së dhe nën kujdesin e Divizionit të Sigurisë së Bashkëpunimit, ky takim me Partnerët mbahet çdo dy herë në vit. Ai siguron një mjedis jozyrtar për një dialog konstruktiv mbi Partneritetet, bashkëpunimin ushtarak dhe tema të tjera me interes të përbashkët në nivelin ushtarako-politik. Takimi i mëparshëm dy-vjetor i NATO-s me partnerët u zhvillua në nëntor 2024.

Komiteti Ushtarak

Komiteti Ushtarak (MC) është autoriteti i lartë ushtarak në NATO dhe organi më i vjetër i përhershëm në NATO, pas Këshillit të Atlantikut të Veriut, që të dyja janë formuar vetëm disa muaj pas krijimit të Aleancës. Ai është burimi kryesor i këshillave ushtarake për Këshillin e Atlantikut të Veriut dhe Grupin e Planifikimit Bërthamor, dhe u jep drejtim dy Komandantëve Strategjikë.

Rolet dhe përgjegjësitë

Roli kryesor i Komitetit është të ofrojë këshilla të bazuara në konsensus mbi politikën dhe strategjinë ushtarake për Këshillin e Atlantikut të Veriut dhe drejtimin e Komandantëve Strategjikë të NATO-s. Ai është përgjegjës për t'u rekomanduar autoriteteve politike të NATO-s ato masa që konsiderohen të nevojshme për mbrojtjen e përbashkët të zonës së NATO-s dhe për zbatimin e vendimeve në lidhje me operacionet dhe misionet e NATO-s.

Drejtimi strategjik

Komiteti Ushtarak luan gjithashtu një rol kyç në zhvillimin e politikës dhe doktrinës ushtarake të NATO-s në kuadër të diskutimeve në Këshill, Grupin e Planifikimit Bërthamor dhe organe të tjera të larta. Ai është përgjegjës për përkthimin e vendimeve politike dhe udhëzimeve në drejtimin ushtarak për dy Komandantët Strategjikë të NATO-s – Komandantin Suprem të Aleatëve për Evropën dhe Komandantin Suprem të Aleatëve për Transformimin.

Në kohë krizash, tensionesh apo lufte, dhe në lidhje me operacionet ushtarake të ndërmarra nga Aleanca, siç është roli i saj në Kosovë, ajo këshillon Këshillin për situatën ushtarake dhe implikimet e saj dhe bën rekomandime për përdorimin e forcës ushtarake, zbatimin e planeve të emergjencës dhe zhvillimin e rregullave të duhura të angazhimit. Ai është gjithashtu përgjegjës për funksionimin efikas të agjencive në varësi të Komitetit Ushtarak.

Përfaqësuesit e komisionit

Komiteti Ushtarak përbëhet nga oficerë të lartë ushtarakë (zakonisht gjeneralë ose admiralë me tre yje) nga vendet anëtare të NATO-s, të cilët shërbejnë si Përfaqësues Ushtarak të vendit të tyre (MILREP) në NATO, duke përfaqësuar Shefin e tyre të



Mbrojtjes (CHOD). MILREP-të punojnë në një kapacitet kombëtar, duke përfaqësuar interesat e vendit të tyre, ndërsa mbeten të hapur për negociata dhe diskutime në mënyrë që të arrihet një konsensus i NATO-s. Një zyrtar civil përfaqëson Islandën, e cila nuk ka forca ushtarake. Komiteti drejtohet nga Kryetari i tij, i cili është zyrtar i lartë ushtarak i NATO-s. Kryetari drejton Komitetin Ushtarak dhe vepron në emër të tij, duke lëshuar direktiva dhe udhëzime si për Drejtorin e Përgjithshëm të Shtabit Ushtarak Ndërkombëtar dhe për Komandantët Strategjikë të NATO-s.

Mekanizmat e punës së Komisionit

Komiteti mblidhet të paktën një herë në javë në sesione formale ose jozyrtare për të diskutuar dhe vepruar për çështje me rëndësi ushtarake.

Në praktikë, mbledhjet thirren sa herë që është e nevojshme dhe Këshilli dhe Komiteti Ushtarak zakonisht takohen shumë më shpesh se një herë në javë. Si rezultat i rolit të Aleancës, për shembull në Kosovë dhe në Mesdhe, është rritur nevoja që Këshilli dhe Komiteti Ushtarak të takohen më shpesh për të diskutuar çështjet operacionale.

Takime të nivelit të lartë

Ashtu si organet vendimmarrëse politike, ajo gjithashtu takohet rregullisht në nivelin e saj më të lartë, përkatësisht në nivelin e Shefave të Mbrojtjes (CHOD). Takimet në këtë nivel mbahen zakonisht tre herë në vit. Dy nga këto takime zhvillohen në selinë e NATO-s dhe një vend anëtar i NATO-s pret të tretin në formën e një Konference të Komitetit Ushtarak.

Bashkëpunimi me partnerët

Komiteti Ushtarak takohet rregullisht me vendet partnere në nivel të Përfaqësuesve Ushtarak kombëtarë (një herë në muaj) dhe në nivel të CHOD (dy herë në vit) për t'u marrë me çështjet e bashkëpunimit ushtarak. Komiteti Ushtarak gjithashtu mund të mblidhet në formate të ndryshme, për shembull në kuadrin e Këshillit të Partneritetit Euro-Atlantik.

Stafi Ushtarak Ndërkombëtar

Stafi Ushtarak Ndërkombëtar (IMS) është organi ekzekutiv i Komitetit Ushtarak (MC), autoriteti i lartë ushtarak i NATO-s.

Roli dhe përgjegjësitë

IMS është lidhja thelbësore midis organeve vendimmarrëse politike të Aleancës dhe Komandantëve Strategjikë të NATO-s (Komandanti Suprem i Aleatëve në Evropë - SACEUR - dhe

Komandanti Suprem i Aleatëve Transformimi - SACT) dhe shtabet e tyre. Fuqia e tij qëndron në shkëmbimin e informacionit dhe pikëpamjeve me shtabet e Përfaqësuesve Ushtarakë, Shtabin Civil Ndërkombëtar (IS), Komandantët Strategjikë, Grupet e Punës shumëkombëshe dhe Agjencitë e NATO-s, duke siguruar punë efektive dhe efikase të stafit.

Roli i IMS është të ofrojë këshillën më të mirë të mundshme ushtarake dhe mbështetjen e stafit për Komitetin Ushtarak (MC). Ai është përgjegjës për përgatitjen e vlerësimeve, studimeve mbi çështjet ushtarake të NATO-s që identifikojnë fushat me interes strategjik dhe operacional dhe propozon kurse veprimi.

Mekanizmi i punës

IMS drejtohet nga një Drejtor i Përgjithshëm, në nivelin e një gjenerali ose oficeri flamuri me tre yje, i ndihmuar nga 12 gjeneralë/oficerë flamuri që drejojnë divizionet dhe zyrat e mbështetjes administrative brenda IMS. Është në gjendje të kalojë me shpejtësi në një regjim krize 24/7 për një periudhë të kufizuar kohore pa personel shtesë.

Disa pozicione kyçe janë të vendosura brenda ose të bashkangjitura në Zyrën e Drejtorit të Përgjithshëm të IMS: Zyra e Koordinatorit Ekzekutiv (EXCO). EXCO është Sekretari i Komitetit Ushtarak, i përgjigjet drejtpërdrejt Kryesuesit dhe gjithashtu përgatit vizitat e KM dhe ofron mbështetje sekretare për KM; Zyra e Këshilltarit të Çështjeve Publike dhe Komunikimeve Strategjike (PASCAD). PASCAD këshillon Kryesuesin dhe Zëvendës Kryesuesin e KM, dhe Drejtorin e Përgjithshëm të IMS-së për komunikimet strategjike dhe çështjet e çështjeve publike; Zyra e Kontrollorit Financiar (KF). KF këshillon zyrtarët kryesorë për të gjitha çështjet financiare dhe fiskale të IMS; Zyra e Zyrtarit Ligjor (LEGAD). LEGAD ofron udhëzime për të gjitha çështjet ligjore për Kryesuesin dhe Zëvendëskryetarin e KM, Drejtorin e Përgjithshëm të SIM-së dhe të gjitha organizatave nën autoritetin e kësaj zyre, dhe MC-në; Zyra e Këshilltarit Gjinator (GENAD). GENAD ofron këshilla dhe mbështetje për IMS për çështjet gjinore. Është pika qendrore e përhershme për mbledhjen, sigurimin dhe shkëmbimin e informacionit në lidhje me programet, politikat dhe procedurat kombëtare për këto çështje, duke përfshirë zbatimin e Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për Gratë, Paqen dhe Sigurinë (RKS KB 1325 dhe 1820).



Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

ZIADIN ÇARÇANI, KORRIERI PARTIZAN I TRUPËZUAR ME LIRINË



Me rastin e 103-vjetorit të lindjes dhe 81-vjetorit të rënies në afërsi të fshatit Zhej të Zagorisë, të dëshmorit të LANÇ-it, birit të Fushëbardhës Ziadin Çarçani (e mërkurë 28.2.1923 – e hënë 5.6.1944), dhe 80-vjetorit të fitores mbi nazi-fashizmin; eshtrat e dëshmorit Ziadin Çarçani prehen në varrezat e dëshmorëve të Gjirokastrës. Ziadin Çarçani është i shpallur me titullin “Dëshmor i Atdheut” me Vendim nr.65 datë 2.10.1971 të ish-Komitetit Ekzekutiv të Rrethit Gjirokastrë si dhe është njohur sipas legjislacionit zyrtar pranë Komisionit Qendror të statusit “Dëshmor i Atdheut” pranë Ministrisë së Mbrojtjes.

Të përbashkuar rreth idealeve antifashiste

Ziadin Shemo Çarçani ishte lindur në Fushëbardhë të Gjirokastrës, më 28 shkurt të vitit 1923. Fisi Çarçanaj, ku erdhi në jetë ishte një fis i njohur dhe i shquar në Fushëbardhë, edhe pse ishte i ardhur nga bregdeti (thoshte gojëdhëna). Babai i Ziadinit, Shemshua ose Shemo, sikurse e thërriste fshati dhe nëna e tij Iblua ishin njerëz plot halle, që përveç halleve familjare ishin shtuar dhe hallet e pushtimeve që nuk iu ndanë Shqipërisë dhe shqiptarëve. Edhe pse babanë e kishte fizikisht të pamundur, Ziadini që fëmijë iu bë krah familjes, mësoi historitë e fisit të vet dhe nderimi dhe respekti i fshatit ishte i dukshëm për fisin e tij. Me gjithë fukarallëkun ai ndoqi katër-pesë klasë fillore dhe iu përvesh punëve që fëmijë, punëve bujqësore dhe sidomos me blegtori në mal, në dimër, shi, borë e breshër. Fshati e njihte si “djali me bërrec/shark” dhe llabane. Të rriturit e mëhallës e shihnin me sy të mirë dhe tek hidhte shtat mes halleve. Ziadini njërën dorë e kishte tek parmenda, si bujk, dhe hapin e ndalte në mal si blegtor, natyrshëm në punët e fshatit. Kjo ia rriti vlerën, ia poqi mendimin dhe veprimin, veçanërisht pas pushtimit të 7 prillit 1939, bëri një grup djemsh të fshatit të shpreheshin të revoltuar dhe të mbushur me urrejtje për fashistët që na kishin shkelur vendin. Në këtë periudhë edhe pse 15-16 vjeçare ishte bindshëm më i rritur dhe i burrëruar. Kohët e egra të pushtimit e bënë të lidhe me grupet e ilegalëve të fshatit dhe të krahinës dhe të kryente detyra në ilegalitet për lëvizjen çlirimtare që sapo kishte nisur. Ziadini gëzonte vetitë më të mira të luftëtarit por dhe të korrierit ndërmjet formacioneve të mëdha luftarake të UNÇSH-së: i fortë, i shpejtë, i guximshëm, tepër i zgjuar për t'i drehuar armikut.

Nëpër rrënjët e fisit “Çarçani” në Fushëbardhë

Si në çdo vatër labe, djemtë e vajzat mëkoheshin dhe e mësonin historinë e tyre në vatrën e zjarrit, ku bashkë me prushin trazohesh e shkuara, ku shqiptarët mbijetuan përmes betejash të panumërta të përgjakshme me gjithfarë pushtuesish. Atje në fatin e tyre në çarçanajt e Fushëbardhës mësoi dhe Ziadini historitë dhe legjendat labe. Në Fushëbardhë gjen legjenda e histori të shumta edhe përtej historisë së Shpellës së Zhulit, ku prijësi Papa Zhuli, ka vendosur ligjet e para në Labëri dhe ka nënshkruar dhe marrëveshjen e parë më 22.6.1081. Nga ana tjetër për shekuj me radhë Fushëbardha, Piksi, Honi, Gropa Zhulit, Bidërgjoni, Zhulati, fshatrat përreth, mbarë Labëria e shkuan historinë me jatagan, pushkë e penë, duke i dhënë dritë epokave, nga “Legjendari Idriz Sulli/Proda;/Kapedan i prerë; Kanunet i vuri;/Shkrojtë në defterë;/ Me vulë e me besë...”. Kështu Ziadini u rrit me heroizmat e të parëve, trimëritë, betejat, këngët, memorien e fshatit në vargje: “...Dhimqurk e Llagaturë,/ kërcet briri gur mbi gur,/ për mbi gur e breg më breg,/ zini shtigjet e tepetë./”. Luftërat ne shqiptarët nuk i deshëm, por ato na u imponuan. Kështu luftërat anti-tanzimat, katër luftërat për Vilajetin e Janinës, betejat e Meçovës, në Artë, Pesë Puset, Bezhan, Grebene, Qafë Gjashtë, Sarandë, Bradhomë, Palavli, Delvinë, luftës anti-andarte në Skërficë, luftërat për Pavarësi, Lufta e madhe e Vlorës dhe kudo ku zëri i Atdheut i kërkoi, ishin bërë për banorët e Fushëbardhës sikurse edhe për Çarçanajt deviza për jetën, për të rrojtur të lirë, “në hisenë e diellit që u takonte”. Fshati dhe krahina më së shumti Ziadinin dhe djemurinë të përbashkuar në idealet antifashiste i mban në memorie si djalin 20 vjeçar, kur çdo vatër e fshatit dhe e krahinave të Kardhiqit e Rrethomës e kishin si birin e tyre. Ziadinin e donin si djalë i mbarë dhe i hedhur që edhe ai i donte njerëzit me zemër dhe shpirtërisht pasi ishte i thjeshtë, i dashur, njerëzor dhe gojëfolë. Ziadinin e poqën hallet para kohe dhe bindshëm iu përbashkuar lëvizjes nacionalçlirimtare që në fillimet e veta. Ai kreu detyra në çetë, në batalion dhe në brigadë, por më shumë se kudo shkëlqeu në detyrën mjaft të rëndësishme si korrier në brigadën e tetë sulmuese dhe sidomos në tej si korrier i Shtabit të Zonës së Parë Operative e deri në korrier të njërive të mëdha që vepronin në Jug të Shqipërisë me Shtabin e Përgjithshëm të UNÇSH-së. Oxhaku fisnik e aristokrat i Çarçane në Fushëbardhë solli në jetë edhe Ziadinin. Ziadin Çarçani ishte lindur në një derë të fisme të fshatit Fushëbardhë në ditën e fundit të shkurtit 1923. Fisi i tij e kishte origjinën nga fshati i kapedanëve, nga Qeparoi që dikur thirreshin me mbiemrin “Gjika”. Por emigracioni në Korfuz dhe gjetkë dhe më tej me vështirim sërish nga vendlindja pas 400 vjetësh erdhën si vëllazëri një pjesë në fshatin e mirënjohur Senicë, që mbeten me të njëjtin mbiemër dhe një pjesë u bënë “Çarçan”. Më shumë shkruhet tek Papa Gjika, Nik Gjika, por dhe tek libri i Ing. Parim Çarçani (me banim në SHBA). Fushëbardha në djepin e historisë labe është e tej mbushur me histori, legjenda, trimëri, lavdi, ka lindur trima e njerëz të pushkës dhe të penës. Fushëbardha ka bërë emër në të gjitha epokat e sidomos në luftërat për liri e pavarësi që trimat e këtij fshati kanë derdhur gjakun në mbrojtje të truallit arbëror, të njohura dhe të dokumentuara nga luftërat anti-tanzimat e deri në luftën e madhe antifashiste, ku Fushëbardha fali jetën e 15 bijve e bijave të saj që janë sot dëshmorë të Atdheut. Ndërmjet tyre edhe trimi dhe korrieri i formacioneve të mëdha partizane Ziadin Shemsho Çarçani.

Djali fushëbardhas në “Yje të pashuar”, vepër monumentale për dëshmorët e Shqipërisë

Në serinë e 20 librave “Yje të pashuar”, të shkruarit fushëbardhas Resul Bedo ka zënë vend edhe dëshmori Ziadin Çarçani, një skicë për Zajdin Shemsho Çarçani, Yje të pashuar, Vëll. IV, Tiranë, 1978, f. 181-183: “Ishim të vegjël kur u njohëm me Ziadinin.

Mësonim në shkollë. Ne ishim në vitin e parë të fillores, ndërsa Ziadini në vitin e katërt. Ishte një nga nxënësit më të mirë të shkollës, por mundësitë që të vazhdonte mësimet nuk i kishte. Ishte i varfër. Babai i Ziadinit, sakat nga sytë dhe këmbët, dërgjej gjatë dimrit në shtëpi pranë zjarrit dhe në verë nën hijen e rrapit të Fushëbardhës. Ende ishte i vogël Ziadini kur mori përpara tufën e deleve të të tjerëve për të fituar bukën e gojës dhe një palë opinga llastiku. Në dimër, në shi e në breshër ishte Ziadini. Njerëzve u vinte keq që varfëria e kishte goditur tmerrësisht familjen e tij. Ende djaloshi në mal me një kalë të dobët që i numëroheshin brinjët nga larg, çonte në shtëpi ndonjë barrë dru, çonte në mulli ndonjë thes me misër. Gëzimi i Ziadinit ishte vetëm nëna e tij, nënë Iblua. E donin të gjithë këtë nënë, Ziadinit i vinte mirë që njerëzit flisnin mirë për nënën e tij. Edhe kur sëmurej, Ziadini mbetej jashtë e nën brucin e tij të vjetër pa flokë ruante delet. Ishin kohë që me vështirësi mund të jetohej. “Jetë qeni, kjo jeta ime”, na thoshte Ziadini. E donim Ziadinin. Ishte njeri i çiltër, buzëgaz dhe neve të vegjëlvë na dilte gjithmonë krah. Kur doli partizan, nëna i qepi Ziadinit një gjerdan për fishekët. E pashë kur e puthi me mall. Ziadinit i flakëronte balli, i shndrisnin sytë. Iku...Të pres- më tha, të pres në çetë. Dhe u nis. Nga ajo ditë nuk u takova më me të. Shokët e tij më thanë se në pranverën e vitit 1944 u ngarkua me detyrën e korrierit. Do të shërbente pranë BrVIII dhe Shtabit të Zonës së Parë Operative Vlorë- Mallakastër-Gjirokastrë. Që në bisedat e para me shokët e Shtabit, e kuptoi rëndësinë e detyrës së vet. Prandaj e kreu atë më së miri, në çdo rast, pa përfillur rreziqet e sakrificat. Atij i takonte të udhëtonte ditë dhe natë, në dëborë e në llojë, nëpër malet e Kurveleshit e të Zagorisë. Asnjëherë s’e hoqi nga mendja se korrieri duhet të jetë i shpejtë, i guximshëm, t’i drehohet me zgjuars armikut. Në fillim sikur e ndiente veten larg nga sakrificat e shokëve që ndesheshin ballë për ballë e ditë për ditë me armikun. Ndërsa ai kur haste me armiqtë duhej të drehonte, të mos u binte në sy, edhe sikur të ishte i sigurt se nuk do ta gjente gjë. Por me kohë e kuptoi se detyra që i kishin ngarkuar nuk qe më pak e rëndësishme. Pas ca kohësh, Ziadini u caktua korrier në Shtabin e Përgjithshëm...”.

Nga luftëtar çete, batalioni e brigade në korrier shtabi

Në luftë nuk ka detyrë të lehtë, në front apo në prapavijë, por detyra e korrierit në kushte lufte ishte sa specifike aq edhe e rrezikshme. Fillimisht Ziadin Çarçani e zgjodhi vetë të linte kërrabën dhe të rrëmbente pushkën për liri që kur ishte në moshën 19 vjeçare në 12 dhjetorin e vitit 1942, kur në Fushëbardhë u krijua çeta e parë partizane e krahinës së Kardhiqit, që mori emrin “Çerciz Topulli”. Kjo është çeta që i kaliti partizanët e saj në betejë. Më 7.8.1943, krijohet batalioni “Asim Zeneli” tek rrapet e Kardhiqit e Prongisë.

Ndërkohë që Lëvizja Antifashiste Nacional -Çlirimtare në pranverën e vitit 1944 ishte shtrirë dhe fuqizuar në të gjithë vendin, krijohet Brigada e Tetë Sulmuese, më 25 Prill 1944, në Sheper të Zagorisë, ku nisi edhe udhëtimi luftarak kjo njësi e re, me 915 luftëtarë, ku 46 ishin të moshës fare të re, prandaj edhe thirreshin “Partizanë-pionierë”. Ata vinin nga repartet ekzistuese, përkatësisht nga batalionet “Çamëria”, “Perlat Rexhepi”, “Koto Hoxhi”, “Misto Mame”, “Thanas Ziko”, “Dëshnica”; nga Grupi i Parë i Kurveleshit, Grupi i Tretë, por dhe nga zona e Mallakastërës. Efektivi do të drejtohej nga 93 kuadro të niveleve të ndryshme, midis të cilëve veçojmë: Qazim Kondi, i kompletuar më së miri si njeri, fjalëmbël e zemërzjarrtë; Asaf Dragoti, me kulturë të plotë ushtarak dhe me dhunti për të drejtuar e komanduar; Pano Xhixho, i shtruar dhe me pjekuri të veçantë; Theodhori Mastora, “Hero i Popullit”, që parapëlqente sulmin mbi armikun dhe jo tërheqjen; Feti Smokthina e Rasim Bazo, që drejtuan njësinë në veprimet luftarake përtej kufirit, e dhjetëra të tjerë me jo më pak kontribute. Flamurin Luftarak në emër të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë e dorëzoi, Qazim Kondi, i cili përpos të tjerash shprehu besimin e palëkundur se këtë simbol nderi e burrërie, partizanët e kësaj brigade do ta mbanin lart me nder e lavdi dhe do ta shpien fitimtar nga beteja në betejë. Në rreshtat e Brigadës së 8-të Sulmuese ishin edhe disa partizanë nga Fushëbardha si Dilaver Habil Poçi kuadrë brigade, Republika A. Çarçani, Kano N. Çarçani, Heqerem H. Çarçani, Ferhat Neki Golemi (korrier në kompaninë e shtabit) dhe Zijadin Shemsho Çarçani që më tej mori

detyrën e rëndësishme të korrierit midis Brigadës dhe njërive të tjera të mëdha bashkërenduese luftimesh e deri me Shtabin e Përgjithshëm të UNÇSH-së. Për cilësitë luftarake dhe morale që shpalosi efektivi i Brigadës VIII Sulmuese, nga armiqtë është etiketuar “Brigada e Parë e Re”, për nga forca, vrulli dhe aftësia luftarake tepër e lartë si dhe për manovrueshmëri në terren fushor, kodrinor e malor. Brigada e tetë Sulmuese pati 148 partizanë e partizane, që dhanë jetën për lirinë dhe sot janë dëshmorë të Atdheut, ku një ndër ta është edhe korrieri partizan nga Fushëbardha Ziadin Çarçani. Por nga ana tjetër biri i Fushëbardhës Ziadin Çarçani i përket si dëshmor gjithë strukturave të mëdha ndërluftuese, sepse në operacionin e qershorit të vitit 1944, kryente rolin e rëndësishëm të korrierit midis brigadave, Zonës së Parë operative dhe Shtabit të Përgjithshëm. Fare pak muaj pas krijimit të kësaj brigade, më 4 gusht 1943, në Kuç të Kurveleshit u krijua Zona e parë Operative (Z1Op), e vetmja në llojin e vet, që u shtri në rreth 6000 km² në Vlorë-Gjirokastrë-Mallakastër, prandaj edhe funksioni i korrierëve sikurse ishte Ziadini merre rëndësi të posaçme në koordinimet dhe bashkërendimet luftarake të njërive të mëdha. Korrierëve si Ziadin Çarçani dhe shokët e tij do t’i duhej të lëvizte në gjithë zonën e shtrirjes së Z1Op në Sarandë, Delvinë, Gjirokastrë, Tepelenë, Përmet, Vlorë, Mallakastër dhe pjesërisht edhe në Fier. Ata kalonin male, lumenj, gryka, lugina e fusha. Ata dinin në çdo kohë rrugë-furnizimet e armikut, manovrimet, tërheqjen dhe komunikimin e garnizoneve në Shqipërinë Jugore. Detyrat i merrni nga Islam Radovicka si komandant i Z1Op dhe komisari Bedri Spahiu. Korrieri fushëbardhas dinte të orientohej dhe zbatonte urdhrat në çdo kohë në çdo orë të ditës dhe të natës, pasi kishte intuitën, mençurinë, njihte mirë rëndësinë e urdhrit luftarak, parullat dhe kundër-parullat partizane, urdhrat dhe udhëzimet e instruksionet që dilnin nga Shtabi i Z1Op, por dhe sidomos ato që vinin nga Shtabi i Përgjithshëm i ushtrisë çlirimtare. Në letrat dhe direktivat që çonte korrieri Ziadin Çarçani flitej qartë në mënyrë të koduar për “formacionet partizane të Z1Op që iu vendosesh detyra konkrete për ngritjen e Brigadave Sulmuese që stadi i luftës i kërkonte që të ngriheshin për rritjen e vrullit të luftës sulmuese që stadi i luftës i kërkonte që të ngriheshin për rritjen e vrullit të luftës çlirimtare”. Kështu në këtë zonë luftarake që ishte prushi i ndezur i luftës kundër pushtuesve u ngritën BrVS, ku planifikimi ishte më 27-28 nëntor 1943, por për arsye të ndeshjes me luftime brigade u krijua, më 20 janar 1944, në Bramyshje të Tërbaçit, përbri fushës së Horës (Vranishtit); BrVIS, më 26.1.1944 në Përmet, BrVIII, më 20 prill 1944, në Sheper të Zagorisë; BrXIIS më 20.5.1944 në Sukë të Përmetit, BrXIVS, më 17 gusht 1944 në fushën e Sheperit, BrXIXS, më 30 gusht 1944 në Theollogo të Sarandës dhe BrXIS, më 1 nëntor 1944 në qytetin e Fierit. Këto ishin njësitë e mëdha që u krijuan me urdhrë të komandantit e komisarit të SHP të UNÇSH-së, që misionin e ngarkuar e kryen me sukses të plotë përpara historisë, edhe pse Shqipëria u bë e lirë, në krahun e duhur të historisë dhe me të drejta të plota e legjitime falë gjakut të derdhur nga dëshmorët tanë në të gjithë truallin shqiptar, edhe jashtë kufijve administrativë shqiptarë për çlirimin e trojeve shqiptare në Kosovë dhe në Mal të Zi e deri në Bosnjën jugore. Partizanët shqiptarë e çliruan vetë vendin pa ndihmën e forcave të huaja dhe me gjakun e bijve dhe bijave të saj më të mirë.

Poeti fushëbardhas që e përjetësoi në vargje: “Korrier vrapimtar,/ Për vrap kishe lindur,/ Korrier Ziadini,/ Maleve i rritur...”

Dhe një ditë qershori të vitit 1944, kur ende s’i kishte mbushur 20 vjeç, djaloshi nga Fushëbardha e Gjirokastrës, në Operacionin e dytë gjerman, ra në fushën e nderit, por mbeti në përjetësi si korrieri i trupëzuar me lirinë. Ndërkohë që një poezi e gdhendur shpirtërisht e trupëzoi korrierin partizan nga Fushëbardha si lajmëtarin e lirisë. Ja vargjet-këngë: *Hapi mbi dëborë,/Majave me erë,/ Pishat tundin flokët,/ Malet kokën ngrënë./ Hej, shpejtoje vrapin./ Se dikush të pret,/ Ja, atje te kthesa,/ Ja, atje në shteg!// Plumbi ku të gjeti,/ Korrier vrapimtar,/ Hapin sec ta treti,/ Mbi borën e bardhë./ Hej, korrier, vrapo,/ Pishat kokën ulin,/ Sikur lot lëshojnë,/ Sikur të përkundin./ Vallë, ç’ke në gj/, Ç’letër të ka mbetur?./ Letrën që atëhere,/ Në gjoks e ke ngjeshur.../ Dhe pse re diku,/ Në një qafë mali./ Vrap kurrë s’t’u sos,/ Vrapin kush s’ta ndali!// Se vrap qe yti,/ Për vrap kishe lindur,/ Korrier Ziadini,/ Maleve i rritur...”, vargje plot ndjenjë të poetit Zeqir Cama, që ia kushtonte korrierit të forcave partizane, dëshmorit të Atdheut Ziadin Çarçani. Ziadin Çarçani është shpallur me titullin e lartë “Dëshmor i Atdheut”. Për këtë ai ka skedën e dëshmorit në departamentin e dëshmorëve pranë Ministrisë së Mbrojtjes por edhe në Organizatën e Dëshmorëve të LANÇ-it dhe dëshmorëve të tjerë të Atdheut, në qendër si dhe në Degën e dëshmorëve të Bashkisë së Gjirokastrës: “Ziadin Shemsho Çarçani, lindur më 28.2.1923, në Fushëbardhë dhe rënë më 5.6.1944 në fshatin Zhej Zagori, në moshën 21 vjeçare. Ka qenë partizan i batalionit territorial dhe Korrier i SHP. Shpallur “Dëshmor i Atdheut” me Vendim Nr. 65 datë 2.10.1971 të Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të rrethit Gjirokastrë. Eshtrat e tij prehen në Varrezat e Dëshmorëve të Gjirokastrës”. Historia shqiptare e luftërave të popullit tonë flet qartë për mençurinë, trimërinë dhe lavdinë e burrërisë shqiptare shekujve, pasi trualli ynë ka nxjerrë nëpër shekuj heronj e dëshmorë që nuk u dhimbsej jeta e as gjaku përpara shenjtërisë së Atdheut e kombit, përpara idealit të shqiptarizmit. Këta djem e burra luftëtarë sakrifikuan rininë në emër të lirisë dhe përjetësia do t’i shoqërojë përjetësisht në altarin e komit me refrenin e njohur të këngës: “...Ju kish rritur nëna,/ për një botë të re,/ lule more trima,/ që ratë për atdhe”. Dëshmori Ziadin Çarçani me veprën e tij heroike shkroi historinë e fitimtarëve, prandaj edhe ngeli në histori. Nuk është e rastit që Uinston Çurçill, “britaniku më i madh në histori”, ka lënë mjaft definicione mbi luftën dhe të rënë, mbi fitimtarët dhe humbësit, por ajo çka la gjurmë të thella në realizmin e pas-luftërave ishte ajo që, “historia shkruhet nga fitimtarët”, pasi trimëria me të drejtë është vlerësuar si cilësia e parë njerëzore”, sepse cilësia është garante e të gjithë të tjerave me objektivitetin e përcaktuar sipas kohës. Koha kërkonte heronj dhe dëshmorë dhe truall shqiptar nuk i kurseu ata, prandaj janë dëshmorët në rrënjët e kombit shqiptar që shkruan pavdekësinë dhe mbijetesën e kombit shqiptar.*



Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ

Në historinë e luftërave shekullore të popullit tonë për liri e pavarësi, për një jetë të lirë nga shfrytëzimi dhe padrejtësitë shekullore, gruaja shqiptare ka luajtur një rol të rëndësishëm. Në vitet 1918-1920 Parashqevi Qiriazi kryesoi me dinjitet delegacionin e kolonisë shqiptare të Amerikës, që mbrojti çështjen shqiptare përpara Konferencës së Paqes në Paris. Lufta e Vlorës e vitit 1920 u shqua për pjesëmarrjen dhe rolin aktiv të grave vlonjate e të krahinave të tjera të vendit në këtë luftë. Gratë vlonjate ndihmuan luftëtarët që luftonin në front e në prapavijë kundër pushtuesve italianë, ndërsa mjaft gra të tjera nga krahina të ndryshme të vendit morën armët, lanë familjet dhe shkuan në Vlorë për të dëbuar nga trualli i atdheut ushtrinë pushtuese. Kudo, në fshat e në qytet u mobilizuan gratë në ndihmë të luftëtarëve. Ato u rreshtuan në front, përkrah luftëtarëve që në ditët e para të luftës. Kështu gra luftëtare nga Dukati, Smokthina, Bolena, Salaria, Kurveleshi, etj., u gjendën në vijën e frontit, të luftimeve. Ato dhanë një kontribut të dukshëm, në prapavijë, duke bërë furnizimin me armatim, ushqim, veshmbathje, etj. Të shumta ishin aktet trimërore që u regjistruan në atë luftë epope, jo vetëm nga Vlora, por edhe nga Gjirokastra, Mallakastra etj.

Në këtë luftë gratë kryen detyra të rëndësishme për furnizimin e frontit me municion, me ushqime, si dhe tërheqjen e transportimin e të vrarëve dhe të plagosurve me kafshë dhe në krahë nga frontet e luftës. Ndihma e tyre krijoi mundësi nga njëra anë që fronti të kishte më shumë luftëtarë dhe nga ana tjetër inkurajoi dhe u dha zemër luftëtarëve.

Gratë, ndonëse ishin të shtypura, që lindnin dhe vdisnin pa lënë gjurmë në jetën shoqërore, politike, ndonëse rriteshin e brumoseshin në gjirin e ngushtë të familjes patriarkale, shpërthyen duke e ndarë lavdinë me burrat. “Gjalmëzëzat”, siç i quan poeti popullor gratë, e përbuzën frikën dhe frikakakun, e mallkuan të birin, kur i ligështojë betejës a vdekjes. Ato tërhoqën të plagosurit nga fronti, i mjekuan me gjethet e barërat e malit, u qepën xhamadanët e shpuar nga plumbat dhe luftuan së bashku me luftëtarët: “me dyfek e spatë në dorë/... u ngrënë burra dhe gra,/ mbi të gjitha Sadoja/ s’ish grua, po ezhdërha,/ në armi q bëri hata,/ asnjë plumb bosh s’i ra”.

Afize Rukës me shoqe, iu besua furnizimi i luftëtarëve me ushqime e me pajime. Ajo u vu në krye të një grupi grash, që gatuanin, lanin e pastronin teshat e kryengritësve. Ato, sistemonin, transportonin dhe mjekonin të plagosurit e shumë. Në luftë mungonte personeli mjekësor për punë të specializuara. Gratë në këtë punë i kishte “specializuar” përvoja, kurse armët e luftëtarëve nuk kishin heshtur ditë e natë, pasi dhe të plagosurit mjekoheshin nga gratë dhe shkonin përsëri në vendet e betejave në Gjorm, në Kotë, në Llogora e në Kaninë etj.

Më 3 qershor 1920, në fshatin Tragjas shkoi mareshali me katër karabinierë. Aty ishin vetëm gra, pleq e fëmijë. Ato u dolën përpara me sëpata, sfulq, hanxharë e jataganë, e mareshali u largua i lemerisur nga britmat e grave.

Alem Mehmeti, një nga anëtarët e Komitetit të “Mbrojtjes Kombëtare”, u kthye drejt portës të madhe të oborrit në Qafë të Ramicës dhe me një theks qortimi, ku përzihej kënaqësi dhe krenari bashkë, pyeti me zë të lartë: “Kujt do t’i lëmë shëndetin na, në këtë shtëpi, kush mbetet këtu?”.

Atëherë doli nënë Isafja, gruaja më plakë e të gjitha familjeve të Agajve dhe iu përgjigj me një zë të kthjellët që të dëgjohej anë e mbanë: “Me mua, Alem Aga, me mua do të përshëndetesh. Se burrat e djemtë e këtyre pragjeve dhe ata të gjithë fshatit do të përcillen për në luftë. Na, gratë do të mbetemi në këto pragje, po s’e ka thënë Zoti që të mbetemi vetëm përgjithnjë. Ju shkoni në luftë dhe të luftoni si të parët tuaj. Zoti, ta dini nga unë plaka e vjetër që kam parë shumë, do t’u zbardhë faqen se përpigjeni për vatanin Tuaj. Zoti është si me gazitë, ashtu dhe me shehitët. Mos u turpërofshin këto pragje”.

Rubi Hosi nga Bolena, e shoqja e komandantit trim Toto Hosi, pushkën e kishte mësuar që në vogëli, sidomos në vitin 1913, kur Bolena u dogj nga andartët grekë. Lufta e Vlorës nuk dihej sa do

ROLI I GRUAS NË LUFTËN E VLORËS 1920



të zgjaste, ndaj një ditë ajo u duk në front, poshtë Drashovicës. Luftëtarët e çetës së Bolenës u quanin “motra e çetës”. Luftimet vazhdonin në Sherishtë, Kallafet, afër Kaninës. Luftëtarëve u thahej buza për ujë. Rubia fluturonte nga llogorja në llogore, nga burimi te pozicionet, me vockën në krah e me okaren në dorë. Në luftë ra si trim dhe ushtaraku Toto Hosi, të cilin e qau, e ligjëroi. Ajo rrëmbeu armën e tij dhe luftoi deri sa u arrit fitorja.

Zekia Krasta ishte nga Kreshova e Kolonjës. Kudo që shkonte Zekia ngjallte ndjenjat e patriotizmit, shkonte dyqan më dyqan e shtëpi më shtëpi për të mbledhur ndihma për luftëtarët. Në valën e Luftës së Vlorës, Zekia u kthye nga vullnetarët që do të niseshin e u tha: “A më pranoni dhe mua t’u lidh plagët vëllezërve të mi”? Në mes të brohoritjeve të popullit u nis Zekia, hipur në kalë të bardhë, hejbetë mbushur plot me ilaçe, përpara vargu i vullnetarëve dhe prapa karvani i ngarkuar me plaçka që ajo vetë i kishte mbledhur nga shoqet e saj. U vendos në Llakatund, ku vazhdoi punën pa u trembur si kryeinfermiere.

Më 18 qershor 1920 forcat pushtuese organizuan një kundërofensivë ndaj luftëtarëve popullorë, të shoqëruar me reprezalje ndaj popullsisë së qytetit. Shumë burra u internuan në ishullin e Sazanit, u masakruan fëmijë e gra.

Më 29 maj 1920, Sado Koshena ishte 65 vjeçe kur u krijua çeta e Dukatit, ishte vullnetare e parë së bashku me tre djemtë e saj. Ajo kishte luftuar në Qafën e Llogorasë, më 1914 me grekët. Përsëri u gjend në Qafën e Llogorasë më 5 qershor 1920, dhe mori pjesë në luftime dhe u shpartallua garnizoni italian i ngritur në qafë. Më 12 qershor 1920, shkuan në Drashovicë, e prej andej në çetën e Dukatit edhe në Shashicë, Qafën e Ullinjë, nëpër lagjet e qytetit të Vlorës. Ajo shkonte sa në Dukat, në Drashovicë e në Shashicë dhe u shpinte luftëtarëve armë e ushqime, të mbajtura në shpinë së bashku me gratë e fshatit. Luftëtarja Qeriba Derri mbledhi ndihma të ndryshme dhe i dërgonte në çetën e Shullërit së bashku me mjaft gra smokthinjote. Nga fshati malor i Bashajt ajo mbledhte ndihma në ushqime e veshje për luftëtarët që luftonin qafave e kodrave të qytetit të Vlorës. Midis luftëtarëve ishte dhe i shoqi, Shaqo Derri. Nëna e dëshmorit Razip Hito nga Bashaj i Smokthinës, i tha të birit kur e nisi për në luftë: “Razip të keqen nëna, hasmi nuk durohet brenda, në u vrafsh, vritu në këmbë e vdekja mos të të trembë”. Kur mësoi lajmin e rënies së të birit e qau me ligje krenarie: “U vrave siç të tha nëna, astrit i bukur me rrëmbea”.

Safe Musai nga Salaria e Tepelenës, kur përcolli kunatin, Selam Musa Salaria, për në Smokthinë të Vlorës, ku u bë dhe mbledhja e zgjeruar për fillimin e luftës, i premtoi se do të shkonte me gratë e fshatit në llogore duke shpërë ndihma e bërë luftë. Dhe kështu

bëri. Gratë e Gjirokastrës formuan komisione, mblodhën sende të argjendta (byzylykë, vathë, unaza) e me to blenë ndihma që u duheshin luftëtarëve në Luftën e Vlorës të vitit 1920.

Prefekti i Beratit, Xhafer Ypi, pas takimit që pati me Osman Haxhiun në frontin e luftimeve, shkruan më 17 qershor 1920, për qeverinë e Tiranës: “Moral i popullit është shumë i lartë. Edhe fëmijët e gratë nuk hiqen nga marrja pjesë në këtë luftë, duke thënë se shpirti i Qeverisë është Vlora. Këtë detyrë, së bashku me luftëtarët e lirisë nga të gjitha viset e Shqipërisë e plotësuan edhe gratë, duke e kryer me faqe të bardhë”.

Hamide Mançaj nga Velça ishte përherë e qeshur dhe me fjalën e ëmbël në buzë. Por ajo ishte edhe një nga vajtojcet e njohura të traditës labe, thurte vargje për bëmat e të afërmeve dhe fshatarëve të Velçës, me një botë poetike të thellë. Kënga e saj na vjen nga koha si dëshmi e kohës dhe ka të bëjë me Luftën epope të Vlorës të vitit 1920, me luftëtarët e fshatit Velçë e të krahinave të Labërisë, që derdhën gjakun në luftën çlirimtare për të shpëtuar Vlorën nga thonjtë e okupatorit italian: U derdhën labërit në brinja,/ Prina breshkaxhinjë, prina,/ Me dyfek e me martina,/ Beuni mbushur me trima,/ Luftëtarë si suferina.

Dhe më tej kënga tregon për bombardimin e italianëve më të vendit Sherishtë dhe Qafa e Koçit me mortaja dhe topa, labërit u bënë copa... Kur italianët bënë yxhym,/ U vra trimi Yzeir,/ Njëpër mjegull që pa gdhirë,/ Mbet shehit për Shqipërinë. Në frymëzimin poetik të Hamide Mançaj, patjetër ka patur edhe mjaft këngë të tjera për luftëtarët e shquar, popullorë të Lumit të Vlorës dhe të Labërisë, por gjer tek ne vetëm këto dëshmi kanë ardhur. Hamide Mançaj, së bashku me gra të tjera të çmuara të fshatit Velçë si: Metullahe Zhabaj, Taibe Begaj, Xhurxhi Shollaj, Labikë Demaj, Sadike Hoxhaj, duke patur pranë vetes edhe vajzën e saj, Miserdhe, disa herë shkoi në frontin e luftimeve në Kotë, Drashovicë e Vreshtat e Mëdha, duke transportuar armë e ushqime për luftëtarët.

Në kujtimet e tij, Muço Canaj nga fshati Velçë shkruan “Trimëria e grave velçote u shfaq me dinjitet patriotik edhe në qershor-korrik 1920, kur luftëtarët e Labërisë u derdhën mbi trinçetë e italianëve në Kotë, Sherishtë e Vreshtat e Mëdha në luftime të përgjakshme. Gratë e këtij fshati.... mes shtigjeve të kësaj lufte, çuan armë, municione e ushqime në ballinat e luftës, duke ndihmuar luftëtarët.

Në kuadrin e 105-vjetorit të Luftës së Vlorës, shoqata e historianëve ushtarakë të Shqipërisë do të organizojë veprimtari të ndryshme, si dhe do të botojë materiale me karakter ushtarak që i bëjnë jehonë kësaj lufte të gjerë populllore, që ruajti dhe mbrojti pavarësinë e brishtë shqiptare, tetë vjet pas shpalljes së saj.

SI DRONI LUFTARAK FPV PO NDRYSHON LUFTËN NË UKRAINË PËRDORIMI I DRONËVE FPV NË FORCAT TONA TË ARMATOSURA



Major (R) Msc. Agron BUKAÇI
Specialist/Kërkues për integrimin e STANAG/AP-ve

Ky artikull trajton konceptin e përdorimit të dronit FPV nga Forcat e Armatosura të Ukrainës në përballjen me pushtuesin rus, roli dhe si po i ndryshon luftën përdorimi i dronit FPV. Qëllimi i sjelljes së këtij artikulli për lexuesit e “Gazetës Ushtria” është që nëpërmjet një analize të të dhënave dhe fakteve, së pari të evidentohet dhe të nxirret në pah rëndësia që po merr përdorimi i dronit FPV që në një far mënyre po ndryshon konceptet dhe taktikat e luftës, dhe së dyti mendime dhe ide për futjen në përdorim masiv të dronit FPV në strukturat e Forcave tona të Armatosura.

Si është duke u përdorur droni FPV nga FA- të e Ukrainës.

Lufta në Ukrainë është karakterizuar nga përdorimi i dronëve në shkallë të paprecedentë, me mijëra mjete ajrore pa pilot (UAV) të përdorura për të gjurmuar e zbuluar forcat armike, për të drejtuar goditjet e artilerisë dhe për bombardimin e objekteve.

Sa i përket teknologjisë dhe inovacionit, dronët FPV përfaqësojnë një përparim teknologjik që ka revolucionarizuar mënyrën se si shohim dhe regjistrojmë botën nga ajri dhe gjithë kjo arrijte teknologjike nëse shfrytëzohet në mënyrë efikase jep rezultate të mira aty ku gjen përdorim siç është edhe rasti i përdorimit për qëllime ushtarake nga FA të Ukrainës dhe jo vetëm.

Për t'i shfrytëzuar sa më mirë cilësitë e larta teknologjike që ofron droni FPV, pilotimi i dronëve FPV kërkon një nivel të lartë të aftësive dhe praktikës, duke ndihmuar pilotët të zhvillojnë aftësi të avancuara në manovrimin ajror.

Ukraina ka përdorur dronët të pajisur me armë të ndryshme si granatat, predha të artilerisë të kalibrave dhe llojeve të ndryshme në varësi të situatës në fushëbetejë.

Dronët e vegjël janë përdorur për sulm, në veçanti po gjejnë përdorim të gjithanshëm ata me pamje nga perspektiva e pilotit (FPV), këto mjete ajrore pa pilot janë bërë shumë të njohura për aftësinë e tyre për të sulmuar me shpejtësinë e tyre objektivat e pushtuesit rus si dhe për të transportuar armë, municion dhe ngarkesa të tjera të domosdoshme për trupat e luftimit në vijën e parë apo në vijën e dytë të mbrojtjes.

Dronët FPV janë përdorur si dronë zbulimi për të mbledhur informacion rreth pozicioneve të forcave ruse dhe qendrave të komandës të këtyre forcave.

Dronët FPV janë përdorur si dronë zbulimi për të ndihmuar në orientimin e artilerisë me të dhëna për objektivat e armikut për t'i goditur me saktësi këto objektiva.

Droni i vogël dhe me kosto të lirë FPV ka dëshmuar të jetë një nga armët më të fuqishme në këtë luftë, ku avionët luftarakë konvencionalë janë relativisht të rrallë për shkak të një përqendrimi të dendur të sistemeve kundërajrore pranë vijave të frontit. FPV-të - të krijuara fillimisht për përdorim civil - kontrollohen nga pilotët në tokë dhe përplasen në objektiva, të ngarkuar me eksplozivë.

Publikimi i pamjeve të dëmeve që shkakton droni FPV në objektivat që zgjidhen për t'i goditur në fushën e betejës.

Çdo ditë, njësitë e dronëve nga të dyja ushtritë publikojnë video në mediat sociale, duke demonstruar se si dronët e lirë nga 300 deri në 500 dollarë mund të shkatërrojnë efektivisht pjesë artilerie të kushtueshme ose tanke me vlerë miliona dollarë, duke shfaqur rolin transformues të dronëve në luftën moderne.



Përdorimi i dronit FPV i integruar në strukturat e FA të Ukrainës

Dronët janë përdorur në luftë dhe jo vetëm për dekada - avionë pa pilot, janë testuar që në luftën e dytë botërore. Por lufta në Ukrainë ka parë një shpërthim në shkallën me të cilën ata janë përdorur. FPV janë shndërruar në mjete për kryerjen e funksioneve të specializuara në një nga armët më të rëndësishme dhe më të përdorura në fushën e betejës.

Pjesët përbërëse dhe kostoja e dronit FPV



Kostoja totale e komponentëve të dronit FPV, në Fig.1, duke përfshirë një kokë luftarake shpërthyesë të siguruar me lidhëse kabllosh, mund të jetë deri në 500 dollarë ose më pak.


Mjetet e komandimit dhe personeli që komandon një dron FPV



Një ushtar përdor dronin duke përdorur një telekomandë dhe një kufje e syze që i lejon ata të shohin pamjen nga kamera. Ndërkohë, një tjetër ushtar shikon një kompjuter tablet me harta dhe jep udhëzime.

Dislokimi i dronëve më të vegjël, i cili ishte jo konsistent në fillim të luftës, tani është bërë jashtëzakonisht i organizuar, me UAV-të të integruara tani në strukturën e forcave të armatosura të Ukrainës. Pothuajse çdo brigadë luftarake ka një kompani me dron sulmues, ndërsa shumica e njësive kanë dronë të vegjël zbulimi.

Në përbërje të një brigade të këmbësorisë së mekanizuar në




çdo batalion ka dron zbulimi/diktimi FPV dhe sulmi/hedhës të bombave (Artillery spotting and bomb dropping).

Qeveria ukrainase synon

të prodhojë një milion dronë FPV në vitin 2025. Për ta vënë këtë në kontekst, është rreth dyfishi i numrit të predhave të artilerisë të furnizuara nga i gjithë Bashkimi Evropian gjatë vitit 2023.

Mënyra e përdorimit të dronit FPV në fushën e betejës

Procesi i vendosjes së kësaj teknologjie në fushën e betejës fillon me dronët e zbulimit të pajisur me kamera me specifika të larta që transmetojnë video në kohë reale në ekranin e kontrollit të pilotit të



tyre, duke lejuar operatorin të kërkojë objektivat e armikut nga lart. Njësitë e zbulimit të dronëve përgatisin dhe ngrenë në ajër një dron zbulimi FPV për lokalizimin e objektivave të armikut, dronët mund të jenë me rreze të gjatë veprimi (Long-range drones) dron me rreze të gjatë (shark) peshkaqen 2-5 km ose me rreze të shkurtër veprimi (short range drones) me rreze të shkurtër, dron (Mavic)1km deri në 300 m.

Sapo dronët të gjejnë një objektiv, të tillë si trupa, automjete ose artileri, ekuipazhet që komandojnë dronët ua përcjellin koordinatat komandantëve të tyre.

Komandantët marrin informacion në lidhje me objektivat dhe vendosin nëse do të bëjnë një goditje ose jo. Duke u mbështetur edhe në të dhënat e zbulimit me dron komandantët vendosim lidhur me veprimet për manovrimin e mjeteve dhe trupave në fushën e betejës në rastet kur trupat janë duke zhvilluar betejë me armikun.

Të njëjtat veprime kryhen edhe në rastet kur dronën e zbulimit përdoren në situata të tjera si në rastet e fatkeqësive natyrore si përmbytje, zjarre, tërmete etj., ose edhe në rastet kur dronët përdoren nga njësi të zbatimit të ligjit.

Sulmi ndaj objektivave, efektet, përzgjedhja e municionit që do të përdorë droni FPV në varësi të llojit të objektivit që do të goditet.

Kur objektivat dallohen, koordinatat e tyre u transmetohen komandantëve përmes lajmëtarëve të sigurt dhe futen në Kropyvva, një hartë dixhitale që përmban të dhëna të grumbulluara për objektivat ruse.

Zbulimi i objektivit dhe sulmi ndaj tij


Pas zbulimit të objektivit (siç përshkruhet grafikisht në figurën 8) vjen radha e sulmit për ta goditur dhe asgjësuar objektivin, për këtë qëllim komandantët përcaktojnë metodën më të mirë për të goditur një objektiv të caktuar. Ukraina ka burime më të kufizuara sesa kundërshtari i saj rus, kështu që shpesh duhet të merren vendime të vështira për të ruajtur municionet e pakta.

Për shkak se dronët FPV drejtohen drejt objektivit të tyre, ata janë shumë më të saktë se shumica e artilerisë. Kjo i lejon ata të ndjekin dhe godasin automjetet në lëvizje, të cilat përndryshe do të kishin mundur t'i shmangeshin predhave. Megjithatë, predhat tradicionale ende mund të japin një goditje shpërthyesë shumë më të fortë se kokat më të vogla të dronëve.

Në varësi të objektivit, komandantët vendosin se si ta godasin atë, artileria mund të japë një goditje shumë më të fuqishme, por dronët janë më të mirë në goditjen e objektivave në lëvizje, skenari më i mirë është të shkatërrosh një objektiv të shtrenjtë me një dron, megjithatë shpesh nevojiten disa dronë për të shkatërruar një objektiv të blinduar apo për asgjësimin e trupave që janë vendosur në një rajon të fortifikuar apo në qendra të banuara.

Ushtarët kanë mësuar të kenë frikë nga zhurma ogurzezë e helikave të dronit sipër, pasi kjo shpesh tregon se ata ose janë pikasur ose janë gati të sulmohen.

Përdorimi i shtuar i dronëve në luftë ka detyruar makineritë e rënda si tanket të lëvizin disa kilometra më tej nga vija e frontit, sipas ushtarëve ukrainas. Këmbësorët, ndërkohë, përmendin FPV-të dhe dronët që hedhin municione si kërcënimin e tyre më të madh dhe thonë se tani ka aq shumë dronë në ajër sa është e vështirë të lëvizësh në llogore ose të përforcosh gropat.



Personeli që përdor dronët zgjedh llojin e municionit në varësi të objektivit që do të godasë bazuar në të dhënat e dronëve zbulues, të cilët sjellin pamje në kohë reale për objektivin. Predhat blind-shpuese (armour piercing) është përdorur për shkatërrimin e tankeve dhe mjeteve të blinduara të armikut, armaturë shpuese. Predhat termobarike (thermobaric) përdoren për asgjësimin e forcave të gjalla të armikut të vendosura në rajone të fortifikuara ose në qendra të banuara, kjo armë djeg oksigjenin në ajrin përreth, duke krijuar një vakum shkatërrues. Predhat thërrmuese (cluster) përdoren kundër forcave të gjalla të armikut të vendosura në fushë të hapur pa fortifikim, këto predha kur shpërthejnë shpërndajnë gjerësisht copëzat, duke rritur mundësinë për të goditur ushtarët e kundërshtarit. Kjo përzgjedhje ka rëndësi për faktin se në një konflikt të gjatë dhe të madh, kostoja është thelbësore, sa më pak burime të përdoren për të shkatërruar një objektiv, aq më mirë. Teknologjia e dronit është megjithatë më efektive, kur përdoret së bashku me lloje të tjera armatimi. Edhe pilotët e dronëve FPV, që kanë bërë dhjetëra goditje në objektivat e armikut thonë se do të ishin pothuajse të pafuqishëm pa këmbësorinë dhe artilerinë për të mbajtur vijën e parë.

Çfarë roli po luajnë dronët FPV nga FA të Ukrainës

Dronët FPV (First-Person View) kanë luajtur një rol të rëndësishëm në konfliktin në Ukrainë dhe kanë ndryshuar mënyrën se si lufta moderne po bëhet. Ja disa përfundime mbi përdorimin e tyre në këtë konflikt:

Revizion i strategjive të luftimit: Dronët FPV kanë



Kropyvva, një sistem inteligjence hartografike dhe shënjestrimi i përbërë nga të dhëna të mbledhura nga dronët dhe burime të tjera

revolucionarizuar strategjitë e luftimit, duke ofruar një mjet për sulme të drejtpërdrejta dhe të përshtatshme. Pilotët mund të drejtojnë dronin drejt objekteve të përdorura nga armiku dhe të lançojnë eksplozivë me presion të lartë.

Kostot: Dronët FPV janë relativisht të lirë dhe mund të përdoren për sulme të efektshme, duke sulmuar pajisje dhe armatimet që vlerësohen miliona dollarë.

Manovrimi i avancuar: Dronët FPV kanë aftësi të mëdha për manovrim dhe mund të fluturojnë nëpër hapësirat e ngushta dhe të komplikuar, duke i bërë ato të përshtatshme për sulme të drejtpërdrejta.

Siguria e personelit që i komandon dronët: Pilotët e dronëve FPV mund të operojnë nga distanca, duke shmangur rrezikun e armëve të afërt dhe të bombardimeve indirekte. Kjo ofron një siguri shtesë për pilotët dhe i bën operacionet më të sigurta.

Transformimi i luftës moderne: Konflikti në Ukrainë ka shfaqur një përshkallëzim në përdorimin e dronëve dhe ka bërë që ata të bëjnë pjesën më të madhe të arsenalit luftarak. Dronët FPV kanë krijuar një ndryshim të madh në mënyrën se si lufta po bëhet dhe janë bërë një nga armët më të përdorura në fushën e betejës.

Përdorimi i dronit FPV në Forcat tona të Armatosura

Për faktin se në këtë artikull çështjet që lidhen me përdorimin e dronit FPV në ushtrinë e Ukrainës nuk përbëjnë ndonjë specifikë të veçantë vetëm për FA të këtij vendi në konflikt, por janë procedura që mund të aplikohen edhe në Forcat tona të Armatosura. Duke i konsideruar të ezauruara këto procedura për lexuesin, më poshtë po ndalem shkurtimisht në çështjen që lidhet me përdorimin e dronit FPV në Forcat tona të Armatosura dhe mënyra se si mund të mbrohem nga sulmet e dronëve.

Nisur nga avantazhe që ofrojnë dronët FPV (First-Person View) përdorimi i tyre po merr gjithnjë e më shumë popullaritet, për këtë arsye sjellja e këtij artikulli para lexuesve të gazetës “Ushtria” ka si qëllim së pari: Evidentimin dhe nxjerrjen në pah të faktit se si përdorimi i dronëve po ndryshon konceptet dhe taktikat e luftës dhe jo vetëm, dhe së dyti sensibilizimin dhe nxitjen e idesë që në strukturat e Forcave tona të Armatosura të krijohen grupe të përdorimit të dronëve FPV ose të ngjashëm, këto grupe të përfshihen në organikën e batalioneve të këmbësorisë dhe atyre mbështetëse të përqendruara në vendbazimet kryesore të FA-së dhe atyre të vendosura në rajone të tjera të vendit tonë.

Futja në përdorim e dronëve FPV do t'i shërbente detashmentit të dronëve luftarak lidhur me marrjen e informacionit paraprak mbi objektivat e kundërshtarit ose rajonit ku ka emergjencë, përcaktimin e vendndodhjes, duke i përcjellë koordinatat detashmentit të dronëve me qëllim që pas marrjes së këtij informacioni paraprak komandanti i detashmentit të dronëve të vendosë lidhur me kursin e veprimit në përgjigje të situatës së krijuar.

Avantazhet që ofrojnë dronët FPV do të ndihmojnë në kryerjen e detyrave dhe realizimin e misionit të këtyre strukturave në rast të përfshirjes së këtyre forcave në operacione luftarake.

Një nga detyrat kryesore të strukturave të FA-së është që të ofrojnë ndihmë në raste emergjencash dhe marrin pjesë në shërbime të tjera publike. Në situatë emergjencash civile dronët FPV mund të përdoren në operacionet e kërkim - shpëtimit, monitorimin e zonave të prekura nga fatkeqësitë natyrore, dhe në shërbime të tjera publike.

Dronët FPV (First-Person View) kanë rritur rëndësinë e përdorimit të tyre në Forcat e Armatosura dhe në emergjencat civile për

shkak të aftësive të tyre unike, dronët FPV mund të kryejnë detyra të shumëllojshme në situatë lufte dhe emergjencash civile.

Roli i dronëve FPV në Forcat e Armatosura:

Rekonicioni: Dronët FPV mund të përdoren për të mbledhur informacion për zonat e interesit, duke ndihmuar në planifikimin e operacioneve.

Identifikimi i qëllimeve: Dronët mund të ndihmojnë në identifikimin e qëllimeve potenciale të armikut dhe mund të japin të dhëna të rëndësishme për komandantët, për të vendosur se cilat janë hapat më të rëndësishme që do të ndërmerren për sulmin ose mbrojtjen.

Sulmi direkt: Dronët FPV mund të ngarkohen me armë lëshuese dhe të përdoren për sulme të drejtpërdrejta ndaj objektivave, duke përdorur lloje të ndryshme ngarkesash me eksploziv apo predha në përshtatje me llojin e objektivit.

Inspektimi i zonave të rrezikshme: Dronët mund të përdoren për të inspektuar zonat e rrezikshme brenda rajonit të mbrojtjes ose vijës së sulmit të kundërshtarit pa rrezik për pilotët e tyre.

Në Emergjencat Civile: Kërkimet dhe ndihmat në raste emergjente. Dronët FPV mund të përdoren për të kërkuar individë të humbur ose për të ndihmuar në operacionet e ndihmës në emergjencë.


Monitorimi i zonave të zjarreve: Dronët FPV mund të ndihmojnë në monitorimin e zonave të zjarreve dhe në raportim të saktë të situatës për forcave zjarrfikëse.

Monitorimi i zonave të përmbytura: Dronët FPV mund të përdoren për evidentimin e zonave që rrezikohen të përmbyten, duke përcaktuar pikat më të dobëta nga ku mund të ketë dalje të lumenjve nga shtrati i tyre dhe të përmbysin zona të caktuara. Mund të përdoren për të ofruar ndihmë me medikamente mjekësore ose produkte ushqimore në zona të përmbytura ose të bllokuara nga debora.

Inspektimi i infrastrukturës: Dronët FPV mund të përdoren për të inspektuar gjendjen e infrastrukturës rrugore, për të evidentuar dhe raportuar për dëmtimet e mundshme dhe zonat ku është dëmtuar infrastruktura rrugore për shkaqe natyrore apo shkaqe të tjera.

Kontrolli i mbeturinave tokësore: Dronët FPV mund të ndihmojnë në identifikimin dhe monitorimin e mbeturinave tokësore për të parandaluar probleme të reja të ndotjes së mjedisit me pasojë shëndetësore për banorët dhe gjallesat në zonat e ndotura.

Mbrojtja nga dronët: Sistemet e luftës elektronike (SLE) Electronic warfare (EWS) systems. Për t'u mbrojtur nga dronët po përdoret metoda e luftës elektronike (LE) kundër dronëve, Electronic warfare (EW). Sistemet e luftës elektronike (EW) është provuar të jenë mënyra më efektive për të ndaluar dronët. Të dyja palët në luftën në Ukrainë po përdorin sisteme EW për të bllokuar frekuencat e dronëve në zona të caktuara. Kur sinjali i një droni bllokohet, piloti humbet aftësinë për të kontrolluar mjetin ose nuk mund ta shohë më sinjalin video, në varësi të cilës frekuencë është ndërprerë. Ndërsa sistemet EW të mëdha, të montuara në kamion përdoren për të mbrojtur pajisjet e shtrenjta, njësitë e këmbësorisë kanë filluar të përdorin sisteme më të vogla për të mbrojtur llogoret e tyre - megjithëse efektiviteti i atyre më pak të fuqishëm mund të jetë i paqartë.



Lufta e Rusisë në Ukrainë po 'helmon' mjedisin

Tre vjet më vonë, lufta në Ukrainë jo vetëm që po dëmton jetën e njerëzve, por ka qenë gjithashtu shkatërruese për mjedisin. Efektet afatgjata janë të vështira për t'u gjykuar. Lufta gjithëpërfshirëse e Rusisë kundër Ukrainës filloi tre vjet më parë dhe nuk ka fund në horizont. Edhe nëse konflikti do të përfundonte sot, populli i Ukrainës nuk do të ishte ende i sigurt.

Hulumtimet sugjerojnë se efektet e luftës mbi njerëzit, kafshët e egra dhe mjedisin do të zgjasin gjatë në të ardhmen.

Mjedisi pësoi 56.4 miliardë dollarë (53.8 miliardë euro) dëme në vitin e parë të luftës. Kostoja totale pas tre viteve të luftës ende nuk është vlerësuar.

Një raport i publikuar në përvjetorin e tretë të luftës zbuloi se 229.7 milion ton emetime CO2 u shpërthyen ose u dogjën në atmosferë gjatë tre viteve të fundit të luftës.

Një luftë ndaj njerëzve dhe mjedisit

Studiuesit po gjurmojnë shkallën në të cilën shkatërrimi i peizazhit, granatimet, zjarret pyjore, shpyllëzimi dhe ndotja po ndikojnë në jetën e egër dhe habitatet natyrore të Ukrainës.

Një analizë e vitit 2024 nga një ekip kërkimor amerikano-ukrainas zbuloi se 30% e zonave të mbrojtura të Ukrainës ishin prekur negativisht.

Ekipi, i cili udhëhiqet nga Daniel Hryhorczuk, profesor emeritus në Institutin për Sigurinë Mjedisore dhe Punësore dhe Epidemiologjinë në Universitetin e Illinois në SHBA, ka frikë se pushtimi nga Rusia i termocentralit bërthamor të Zaporizhzhia dhe shkatërrimi i digës Kakhovka do të çojë në katastrofë të qëndrueshme ekologjike.

Përveç kësaj, ata thonë se ajri, uji dhe toka lokale janë të kontaminuara me kimikate në një shkallë të madhe dhe se 30% e Ukrainës është e kontaminuar me mina tokësore dhe municione të pashpërthyer.

Sapo këto kimikate të futen në tokë dhe ujëra nëntokësore, mund të jetë vetëm çështje kohe para se ato të transmetohen te njerëzit nëpërmjet bimëve, kafshëve dhe ujit të pijshëm.

Të paktën, kjo është ajo që toksikologët thonë se mund të ndodhë. Ata nuk janë plotësisht të sigurt se si mjedisi do të



Si një metal i rëndë, mercuri është gjithashtu i dëmshëm për qelizat nervore. “Kjo mund të çojë në defekte të lindjes tek foshnjat e palindura”, - tha Maser.

Plumbi ka efekte të ngjashme dhe mund të shkaktojë çrregullime zhvillimore ose abort.

Kateryna Smirnova, një studiuese në Institutin Sokolovsky

thellë nën tokë.

“Elementet më pas mund të futen në ujërat sipërfaqësore dhe të kontaminojnë përrrenjtë, lumenjtë dhe liqenet”, - tha ai.

Një cikël toksik

Maser tha se nëse kafshët hanë kimikate, ato mund të hyjnë në zinxhirin ushqimor dhe përfundimisht të bëhen të rrezikshme për njerëzit si konsumatorë fundorë.

Ai shtoi se nëse shirat bien, duke lejuar kimikatet të depërtojnë në ujërat nëntokësore, “kjo do të thotë se uji i pijshëm rrezikohet të kontaminohet”.

Bimët mund të konsumojnë merkur dhe kimikate të tjera nëse uji kontaminohet në këtë mënyrë. Nëse këto bimë janë kultura si gruri ose perimet, të njëjtat kimikate do të përfundonin në pjatat tona të darkës.

Dëmi mjedisor në miliarda

Shembulli i Ukrainës ilustron kostot e mëdha të shkatërrimit të shkaktuar nga lufta. Sipas kësaj analize të fundit, lufta në Ukrainë ka shkaktuar dëme mjedisore prej më shumë se 56.4 miliardë dollarë (52 miliardë euro).

Ekipi i Hryhorczuk po bën thirrje që të hetohen pasojat mjedisore të të gjitha konflikteve të armatosura dhe të merren masa më efektive për mbrojtjen e mjedisit gjatë luftës. Ata gjithashtu duan që ata që janë përgjegjës për dëmtimin e mjedisit gjatë luftës dhe ata që nxisin një luftë të mbahen përgjegjës.



merret me këto substanca toksike ose çfarë efekti mund të kenë ato te njerëzit.

TNT është kancerogjen

Ndër elementët më të rrezikshëm në municione janë vetë eksplozivët dhe metalet e rënda. Trinitrotolueni, i njohur më mirë si TNT, është një përbërës nitroaromatik i njohur për fuqinë e tij shpërthyes.

“Ne e dimë përmes eksperimenteve mbi minjtë dhe minjtë se TNT është toksik”, - tha Edmund Maser, drejtor i Institutit për Toksikologjinë në Klinikën Universitare në Kiel, Gjermani.

Maser hulumton efektet e municioneve që u hodhën në pjesën gjermane të Detit të Veriut dhe Baltik pas Luftës së Dytë Botërore - 1.6 milion tonë municione po ndryshken atje.

Toksikologët kanë vërejtur gjithashtu në dete se tritoli i lëshuar nga municionet e hedhura po dëmton kafshët në zonën përreth. “TNT komprometon aftësinë e jetës detare për t'u riprodhuar, rritur dhe zhvilluar”, - tha Maser. “Ne gjithashtu e dimë nga këto studime se TNT dhe eksplozivët e tjerë janë kancerogjenë”.

Mërkuri, arseniku dhe plumbi shkatërrojnë qelizat

Disa metale të rënda, si arseniku dhe kadmiumi, janë kancerogjene.

“Mbi të gjitha, detonatorët përmbajnë metale të rënda, si zhiva në formën e një bulminati që e bën TNT-në të shpërthejë më shpejt”, - tha Maser. Një fulminat vepron si një lloj katalizatori.

për Shkencën e Tokës dhe Kërkimin e Agrokimisë në Akademinë Kombëtare të Shkencave të Ukrainës, tha se mostrat e tokës nga Kharkiv - një nga vendet kryesore të betejës në lindje të vendit - kishin treguar tashmë përqendrime më të larta të plumbit dhe kadmiumit.

Kolegia e Smirnovës, Oksana Naidyonova, një mikrobiologe në Institutin Sokolovsky, shpjegoi se metalet e rënda ndikojnë negativisht në bakteret e tokës.

“Ato pengojnë zhvillimin e bimëve dhe furnizimin me mikroelemente, gjë që çon në defekte fiziologjike dhe zvogëlon aftësinë e tyre për t'i bërë ballë sëmundjeve”, - tha Naidyonova.

Megjithatë, kimikatet nuk do të qëndrojnë domosdoshmërisht në tokë. Maser tha se TNT, për shembull, mund të merret nga era dhe të shpërndahet më larg. Shiu madje mund të arrijë disa nga substancat që gjenden më



Një koncept i popullarizuar nga “Matrix”, “Hipoteza e simulimit”

Filmi “The Matrix” popullarizoi idenë se universi ynë është i simuluar. Por, a është kështu?

Ideja e një universi të simuluar nuk është vetëm pjesë e kulturës popullore, por edhe e botës shkencore; quhet “hipoteza e simulimit” dhe shumë ekspertë argumentojnë se teoria ka më shumë gjasa të jetë kështu sesa jo.

Një pyetje e vjetër filozofike

Megjithëse teoria është rishfaqur kohët e fundit, ajo ekziston për qindra vjet. Në fakt, një nga pyetjet më të vjetra në filozofi është: si e dimë se ekziston diçka?

Filozofi francez René Descartes tha: “Unë mendoj, prandaj jam”, duke shprehur se ne mund të jemi të vetëdijshëm vetëm për vetëdijen tonë, duke mos ditur nëse bota jashtë mendjes sonë është reale.



Simuluar nga një qytetërim “post human”?

Por në ditët e sotme, një argument popullor për hipotezën e simulimit erdhi nga Nick Bostrom i Universitetit të Oksfordit në vitin 2003, i cili sugjeroi se anëtarët e një qytetërimi të përparuar “posthuman” me fuqi të madhe kompjuterike mund të zgjidhnin të ekzekutonin simulimet e paraardhësve të tyre në univers.

Themeluesi i PlayLabs të MIT

Në mënyrë të ngjashme, Rizwan Virk, themelues i programit PlayLabs të Institutit të Teknologjisë në Massachusetts dhe autor i “Hipotezës së Simulimit”, është ndër ata që e marrin seriozisht teorinë e simulimit.



Humbja e gjurmës së realitetit

Në librin e tij, Virk kujton se kishte luajtur një lojë të realitetit virtual aq realist sa harroi se ishte në një dhomë të zbrazët me një kufje në kokë. Kjo e shtyu atë të pyeste veten: A jemi të sigurt se nuk jemi të përfshirë në një botë të krijuar nga qenie më të zgjuara teknologjikisht se ne?

Kjo pyetje ka kuptim edhe për Rich Terrile, një shkencëtar kompjuteri në Laboratorin Jet Propulsion të NASA-s në Pasadena, Kaliforni, i cili argumenton se aftësia për të modeluar qeniet e ndjeshme mund të jetë së shpejti në dorën tonë.

A mundet AI të zhvillojë vetëdijen?

“Ne jemi brenda një brezi që jemi ata perëndi që krijojnë ato universe”, - tha Terrile në vitin 2019, sipas “The Guardian”. Disa vite më vonë, ekspertët e teknologjisë tashmë po diskutojnë mundësinë e ndërgjegjësimit të AI-së dhe implikimet etike që mund të sjellin.

Dëshmi se ne mund të jetojmë në një simulim

Por përveç përparimeve të mëdha në teknologji që kemi bërë vitet e fundit dhe idesë jo aq të sforcuar për të qenë në gjendje të simulojmë një tru njerëzor, çfarë dëshmie tjetër ka që ne mund të jetojmë në një simulim të ngjashëm me Matricën?

“UNË MENDOJ, PRANDAJ JAM” A është realiteti një simulim? Disa shkencëtarë mendojnë që po



Të gjitha objektet fizike mund të reduktohen në grimca

Rizwan Virk, shkencëtar kompjuteri dhe dizajner i video-lojërave tha në një intervistë me ‘Vox’ se një pjesë e provës që tregon se kjo botë është një simulim është fakti se të gjitha objektet fizike mund të reduktohen në grimca, njësoj si pikselët që përbëjnë një imazh.

Çdo gjë që ne shohim si fizike është rezultat i pjesëve të informacionit

Virk përmendi fizikanin John Wheeler, një nga shkencëtarët e fundit që punoi me Ajnshtajnin, i cili doli me frazën “për pak”, që do të thotë se çdo gjë që ne shohim si fizike është në të vërtetë rezultat i pjesëve të informacionit.

Teoria është e mundur nga këndvështrimi i fizikës

Megjithëse Wheeler nuk jetoi për të parë kompjuterë kuantikë, Virk e konsideron teorinë e tij të përshtatshme. “Nëse bota nuk është me të vërtetë fizike, por e bazuar në informacion, atëherë një shpjegim më i thjeshtë mund të jetë në fakt se ne jemi në një simulim që është krijuar bazuar në shkencën kompjuterike dhe informacionin”, - tha ai.

“Një rrethanë jashtëzakonisht e pamundur”

Në mënyrë të ngjashme, shkencëtari kompjuterik i NASA-s, Rich Terrile tha se “sinqerisht, nëse nuk po jetojmë në një simulim, është një rrethanë jashtëzakonisht e pamundur”, - raportoi ‘The

Guardian’.

Simulime të shumta artificiale

“Nëse dikush përparon me shpejtësinë aktuale të teknologjisë disa dekada në të ardhmen, shumë shpejt do të jemi një shoqëri ku ka entitete artificiale që jetojnë në simulime që janë shumë më të bollshme se qeniet njerëzore”, - tha Terrile.

“Nëse në të ardhmen do të ketë më shumë njerëz dixhitalë që jetojnë në mjedise të simuluar sesa sot, atëherë çfarë do të thotë se ne nuk jemi tashmë pjesë e kësaj?”, - pyeti shkencëtari kompjuterik.

Të tjerë që interesohen për “hipotezën e simulimit”

Ekziston gjithashtu një grup ekspertësh të teknologjisë së Silicon Valley të cilët janë interesuar për “hipotezën e simulimit”, si krijuesi i Tesla-s, Elon Musk, i cili ka thënë se ka “një miliard deri në një shans që të jetojmë në realitetin bazë”, sipas “The Guardian”.

A po paguajnë miliarderët shkencëtarë që të na largojnë nga simulimi?

Në fakt, Sam Altman, CEO i Open AI, i tha “The New Yorker” në vitin 2016, se dy miliarderë të teknologjisë “po angazhonin fshehurazi shkencëtarët për të punuar për të na larguar nga simulimi”.

Duke lënë mënjane djemtë e teknologjisë së pasur dhe teoritë e shkencëtarëve, ka disa forume në internet, si “Reddit” që janë të mbushura me dëshmi të njerëzve për atë që ata e quajnë “një defekt në Matrix”; përvoja sureale që i kanë bërë të besojnë se në të vërtetë po jetojnë në një botë të simuluar.


Disa ekspertë janë skeptikë në lidhje me teorinë e simulimit

Por sigurisht, ka ekspertë që janë më skeptikë në lidhje me teorinë e simulimit. “A është logjikisht e mundur që jemi në një simulim? Po. A jemi ndoshta në një simulim? Unë do të thosha jo”, - tha Max Tegmark, një profesor i fizikës në MIT për ‘The Guardian’.

Bota jonë është plot me mistere

Të tjerë, si fizikanja teorike e “Harvardit”, Lisa Randall, thonë se nuk ka asnjë “provë të vërtetë” që tregon se bota jonë është një simulim. Por një gjë për të cilën shumica e ekspertëve mund të bien dakord është fakti se ka ende shumë mistere në botën fizike dhe shumë gjëra që ne nuk i kuptojmë për realitetin tonë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

MINISTRIA E MBROJTJES

MINISTRIA E MBROJTJES



**QPR ka filluar regjistrimin për ushtarë/
detarë aktiv.**

Stërvitja Individuale Bazë do të zhvillohet në periudhën

28.04.2025 - 04.07.2025.

Afati i dorëzimit të dokumentacionit është deri më

31 mars 2025.

Apliko në: <https://www.mod.gov.al/karriera-2/1008-si-te-rekrutohem-ushtar-detar-aktiv-ne-fa>